

UDHËZUES

**PËR MONITORIMIN E FËMIJËVE
JASHTË SISTEMIT ARSIMOR (FJSA)
DHE FËMIJËVE QË RREZIKOJNË
TË BRAKTISIN SHKOLLËN**

Udhëzues trajnimi për institucionet arsimore në nivel vendor, në kuadër të zbatimit të nismës “Çdo fëmijë në shkollë”, mbështetur nga MASR-ja dhe UNICEF-i, zbatuar nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve

Korrik, 2019



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

Ky Udhëzues realizohet në dobi dhe në interes të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të strukturave në varësi të saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E BRENDSHME

Ky Udhëzues realizohet në dobi dhe në interes të Ministrisë së Brendshme dhe të strukturave në varësi të saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

Ky Udhëzues realizohet në dobi dhe në interes të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të strukturave në varësi të saj.



Ky Udhëzues mundësohet falë vëmendjes dhe mbështetjes së zyrës së UNICEF-it në Shqipëri.



Ky Udhëzues u mundësua në bashkëpunimin me zyrën e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, si pjesë e projektit “Çdo fëmijë në shkollë”.



Ky Udhëzues u mundësua në saj të zbatimit të programit “Leave No One Behind- Askush të mos mbetet pas”.

PËRMBAJTJA

SHKURTIME DHE PËRKUFIZIME.....	6
I. PARATHËNIE	8
II. MIRËNJOHJE	11
III. HYRJE	12
<i>III.1. Kujt i shërben ky Udhëzues?.....</i>	<i>12</i>
<i>III.2. Çfarë synojmë të arrijmë?.....</i>	<i>12</i>
<i>III.3. Target-grupet që do të trajnohen</i>	<i>12</i>
<i>III.4. Informacion për trajnimin</i>	<i>13</i>
IV. FËMIJËT JASHTË SHKOLLE	14
<i>IV.1 . Cilat janë grupet e rrezikuara të fëmijëve?.....</i>	<i>14</i>
<i>IV.2. Cilët janë faktorët e rrezikut për mosregjistrimin, mosvijimin dhe braktisjen e shkollës nga fëmijët?</i>	<i>14</i>
<i>IV.3. Në cilat faza duhet të kenë kujdes shkollat dhe grupet e interesit për sa i përket mosregjistrimit dhe braktisjes?.....</i>	<i>19</i>
V. IDENTIFIKIMI I FËMIJËVE JASHTË SHKOLLAVE.....	20
<i>V.1. Cili është profili i përbashkët i fëmijëve që nuk janë regjistruar në shkollë?</i>	<i>20</i>
<i>V.2. Cili është profili i fëmijëve që janë në rrezik të braktisjes së shkollës?</i>	<i>20</i>
<i>V.3. Cili është profili i fëmijëve që kanë braktisur shkollën?</i>	<i>20</i>
<i>V.4. Cili mund t'i identifikojë fëmijët jashtë shkolle?</i>	<i>21</i>
<i>V.5. Cilat janë metodat për identifikimin e fëmijëve jashtë shkolle?</i>	<i>21</i>
<i>V.6. Pse është e rëndësishme analiza e gjendjes dhe si bëhet ajo?</i>	<i>22</i>
<i>V.7. Çfarë treguesish duhet të përdoren për të identifikuar fëmijët në rrezik braktisjeje të shkollës?.....</i>	<i>22</i>
VI. AKTORËT, ROLI I TYRE, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË.....	24
<i>VI.1. Ministritë e përfshira në M3M dhe në U3M</i>	<i>24</i>
<i>VI.2 Roli dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të Qendrës së Shërbimeve Arsimore</i>	<i>24</i>
<i>VI.3. Roli dhe përgjegjësitë e zyrave vendore arsimore dhe e shkollave publike e private</i>	<i>25</i>
<i>VI.4. Roli dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe e qendrave shëndetësore</i>	<i>28</i>
<i>VI.5. Roli dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Brendshme.....</i>	<i>29</i>
<i>VI.6. Roli dhe përgjegjësitë e bashkive.....</i>	<i>29</i>
<i>VI.7. Roli dhe përgjegjësitë e komisariateve të policisë</i>	<i>30</i>
<i>VI.8. Roli i Prefektit.....</i>	<i>31</i>
VII. ANALIZA E GJENDJES DHE HAPAT PËR PËRMIRËSIM	32
<i>VII.1. Hapi I: Ku jemi tani?.....</i>	<i>32</i>

VII.2. Hapi II: Ku duam të jemi?.....	33
VII.3. Hapi III: Si do të arrijmë atje?	33
VII.4. Hapi IV: Si do ta kuptojmë që ia kemi dalë atje ku deshëm të arrijmë?	33
VII.5. Hapi V: Sa do të kushtojë?	33
VII.6. Hapi VI: Cili mund t'i ndihmojë shkollën dhe aktorët e përfshirë në nismën “Çdo fëmijë në shkollë”?.....	34
VIII. SISTEMI I PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM PËR NXËNËSIT NË RREZIK TË BRAKTISJES SË SHKOLLËS	35
VIII.1. Treguesit e rrezikut të braktisjes së shkollës, mungesave pa arsye dhe aftësisë së kufizuar	35
VIII.2. Shkolla virtuale e sistemit SMIA dhe alarmet automatike.....	35
VIII.3. Rekomandime të tjera për sistemin SMIA.....	36
VIII.4. Trajtimi i raportimit të pasaktë të braktisjes dhe i mungesave pa arsye	37
IX. MONITORIMI, RAPORTIMI DHE VLERËSIMI	39
X. SHTOJCAT	40
Shtojca 1: Instrumente për intervista.....	40
Instrumenti 1: Intervista me drejtorin e shkollës	40
Instrumenti 2: Intervista me mësuesin kujdestar.....	42
Instrumenti 3: Intervista me psikologun/punonjësin social në shkollë	45
Instrumenti 4: Intervista me kryetarin e qeverisë së nxënësve bashkë me një anëtar të saj.....	46
Instrumenti 5: Intervista me kryetarin e këshillit të prindërve të klasës.....	46
Instrumenti 6: Intervista me kryetarin e këshillit të prindërve të shkollës.....	47
Instrumenti 7: Intervista me një nxënës që ka braktisur shkollën dhe është kthyer në shkollë....	47
Instrumenti 8: Intervista në zyrën vendore arsimore	47
Instrumenti 9: Intervista në shkollat me tregues të mirë.....	48
Shtojca 2: Fokus-grupet.....	49
FOKUS-GRUPI 1: BRAKTISJA E SHKOLLËS	49
FOKUS-GRUPI 2: MUNGESAT E PAARSYESHME TË NXËNËSVE	49
FOKUS-GRUPI 3: FËMIJËT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.....	50
FOKUS-GRUPI 4: ZBATIMI I RREGULLORES 3-MINISTRORE PËR NXËNËSIT E KLASËS SË PARË.....	50
Shtojca 3: Instrumente për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve në rrezik të braktisjes dhe fëmijëve jashtë shkolle.....	51
Instrumenti 1: Identifikimi i nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës.....	51
Instrumenti 1.1: Fletë identifikimi – Instrumenti i klasës (Sistemi i hershëm i identifikimit)	52
Instrumenti 2: Regjistrimi i rasteve të fëmijëve në rrezik të braktisjes së shkollës	53
Instrumenti 3: Monitorimi i transferimit në shkollë.....	53
Instrumenti 4: Njoftimi për rastet e nxënësve që e kanë braktisur shkollën.....	54

Shtojca 4: Formulari për zhvillimin e planit të veprimit shkollor.....	55
Shtojca 5: Formatet për organizimin e mbledhjeve të ZVA-së dhe shkollës	56
5.1. <i>Formati i rendit të ditës së mbledhjeve të ZVA-së dhe shkollës</i>	<i>56</i>
5.2. <i>Formati i procesverbalit të mbledhjeve të ZVA-së dhe shkollës.....</i>	<i>56</i>
Shtojca 6: Kontratë shtëpi–shkollë për reduktimin e mungesës nga mësimi dhe braktisjes së shkollës	57
Shtojca 7: Formulari i referimit të rasteve për OJF-të	58

SHKURTIME DHE PËRKUFIZIME

AShMDF	Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e Fëmijëve
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
DRSh	Drejtoria Rajonale e Shëndetësisë
DShP	Drejtoria e Shëndetit Publik
DSh	Drejtoria e shkollës
IAVPAP	Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar
KB	Kryetari i Bashkisë
KN	Komisioni Ndërmintor
M3M	Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet tri ministrive, protokolluar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) me nr. 7522 prot., datë 12.07.2018, në Ministrinë e Brendshme (MB) me nr. 8649 prot., datë 22.10.2018 dhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me nr. 6084 prot., datë 23.10.2018, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”
MASR	Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
MB	Ministria e Brendshme
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
NjMF	Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve
NjShPS	Njësia e Shërbimit Psiko-Social
Observatori	Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
OJF	Organizatë jofitimprurëse
OShC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PPNA	Personi përgjegjës i nënndarjes administrative
PPZ	Punonjësi i policisë së zonës
QSh	Qendra Shëndetësore
QshA	Qendra e Shërbimeve Arsimore
SII	Sistemi i Informacionit të Imunizimit
SMIA	Sistemi i Menaxhimit të Informacionit në Arsim
ShKP	Shefi i Komisarariatit të Policisë
ShP	Shkolla publike
U3M	Urdhër i përbashkët i MASR-së, MB-së dhe MShMS-së Nr. 292, datë 28.05.2019, Për miratimin e rregullores për zbatimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive “për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”.
UNICEF	Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
ZVA	Zyra Vendore Arsimore

- **ISCED:** Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit, hartuar nga UNESCO me qëllim lehtësimin e krahasimeve të treguesve dhe statistikave të arsimit të vendeve të ndryshme, mbi bazën e përkufizimeve të njëtrajtshme dhe të pranuar në nivel ndërkombëtar. Shiko gjithashtu: <http://www.uis.unesco.org/isced>, dhe në veçanti versionin e fundit ISCED 2011: <http://www.uis.unesco.org/Education/Documents/isced-2011-en.pdf>.
- **FJSA:** Fëmijët jashtë sistemit arsimor.
- **ISU:** Instituti i Statistikave i UNESCO-s.
- **Llojet e FJSA-së** sipas vizibilitetit:
 - **FJSA të dukshëm:** Quhen FJSA të dukshëm sepse mund të identifikohen duke përdorur SMIA.
 - **FJSA gjysmë të dukshëm:** Këta janë aktualisht FJSA të padukshëm që mund të bëhen të dukshëm përmes të dhënave qeveritare ndërreferenciale dhe kontrollit të regjistrimeve shkollore. Përbëhen nga dy grupet e mëposhtme: (i) *Braktisjet e paregjistruara* - Fëmijët që e kanë braktisur shkollën, por që nuk janë raportuar kurrë si të tillë, që mund të identifikohen

duke përdorur rrjedhjen *vertikale* të informacionit nga shkolla në nivel kombëtar, në veçanti përmes përdorimit të regjistrimit të mungesave pa arsye në nivel nxënësi; (ii) *FJSA që nuk janë regjistruar kurrë në shkollë* - Informacioni për fëmijët që nuk janë regjistruar kurrë në shkollë, mund të mblidhet duke përdorur rrjedhën *horizontale* të informacionit ndërsektorial. Regjistrimet për fëmijët mund të lidhen përmes një ID unike, siç është numri i certifikatës së lindjes, për të identifikuar ata që nuk janë regjistruar në bazën e të dhënave të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, por që janë regjistruar në baza të tjera të dhënash, si regjistri civil dhe vendor.

- ***FJSA të padukshëm***: Këta janë FJSA që nuk janë të dukshëm në ndonjë të dhënë administrative të qeverisë ose në regjistrimet e shkollave, kështu që janë plotësisht të padukshëm. Në përgjithësi, ata përfaqësojnë fëmijët më vulnerabël dhe të disavatazuar.

I. PARATHËNIE

Vendi ynë vazhdon të përballet me ndryshime të mëdha ekonomike, politike, shoqërore, kulturore dhe teknologjike. Gjithë këto ndryshime kanë ndikimet e tyre të padiskutueshme në fushën e arsimit. Arsimimi në Republikën e Shqipërisë garantohet me kushtetutë për të gjithë shtetasit e saj. Të gjithë qytetarëve të RSh-së dhe shtetasve të huaj që banojnë në Shqipëri, në moshën e përcaktuar me ligj, u sigurohet ndjekja e institucioneve arsimore pa asnjë lloj diskriminimi për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, gjuhës, orientimit seksual, bindjeve politike ose fetare, gjendjes ekonomike apo sociale, përkatësisë farefisnore, moshës, vendbanimit, aftësisë së kufizuar, gjendjes shëndetësore, ndonjë statusi tjetër të qytetarit, ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.

Zhvillimet e vrullshme të dhjetëvjeçarëve të fundit, hyrja në ekonominë e tregut, emigracioni, lëvizjet e lira e të pakontrolluara demografike etj. kanë bërë që tek individët dhe familjet, por dhe te grupe shoqërore, të zënë vend preferenca nga më të larmishmet. Jo pak të rinj priren nga rrugë e forma të ndryshme për arritjen e përmirësimit dhe rregullimin e jetës personale e familjare. Për arsye të shumta, për zhvillime e ngjarje pozitive e jopozitive në jetën vetjake, familjare apo farefisnore, individë të shumtë u janë shmangur interesave për arsimim ose kanë qenë të shtrënguar të lënë bankat e shkollës. Treguesit e përvitshëm flasin për ndërprerje të shkollimit nga fëmijët e të rinjtë në nivele të ndryshme të sistemit arsimor. Pavarësisht përmirësimit të vazhdueshëm të shërbimit arsimor përmes forcimit të institucioneve shkollore, rikonstruksionit të shkollave ekzistuese dhe ndërtimit të shkollave të reja me parametra bashkëkohorë, zhvillimit profesional të mësuesve dhe drejtuesve të arsimit etj., faktorë të tjerë, kryesisht ekonomikë e socialë, vazhdojnë të kenë rrezatimin e tyre në dukurinë e braktisjes shkollore. Në vëmendje të institucioneve arsimore mbetet dukuria e largimit të fëmijëve nga shkolla pa mbaruar arsimin e detyruar. Fëmijët që lënë shkollën pa mbaruar arsimin e detyruar, hyjnë në kontingjentet e braktisjes shkollore. Por këtu përfshihen dhe kategori të tjera fëmijësh.

Edhe pse shkalla e regjistrimit të fëmijëve në moshë shkollore në vendin tonë është mbi 99%, ka prova se shumë fëmijë nuk regjistrohen në shkollë ose nuk arrijnë të përfundojnë arsimin bazë.

Arsyet pse fëmijët lënë shkollën para përfundimit të klasës së 9-të janë të shumta: presioni për të kontribuar në të ardhurat e familjes, presioni për t'u martuar dhe për të krijuar familje, presioni shoqëror prej kontingjentëve që e kanë braktisur shkollën, presioni i familjes për të kontribuar në punët e shtëpisë dhe për t'u kujdesur për motrat dhe vëllezërit më të vegjël apo të afërmit, largësia nga shtëpia në shkollë, veçanërisht në nivelin e mesëm të ulët etj. Në disa raste ekstreme, braktisja e shkollës vjen prej fëmijëve të abuzuar, të trafikuar ose të shfrytëzuar.

Arsye të tjera pse disa fëmijë nuk regjistrohen në shkollë janë: aftësia e kufizuar, migrimi dhe varfëria ekstreme.

Hulumtimet tregojnë se kujdesi i komunitetit, i shoqërisë, por edhe i familjes për kthimin apo regjistrimin në shkollë të individit, mund të ndikojë te fëmija që ai të arrijë të përfundojë cilësisht arsimin bazë, dhe jo vetëm kaq. Niveli arsimor i njerëzve ndikon:

- Forcimin ekonomik të vetë individëve, të familjeve të tyre dhe të shoqërisë.
- Gjendjen shëndetësore të individëve dhe të familjeve, duke përfshirë edhe fëmijët e tyre.
- Barazinë më të madhe gjinore.
- Përfshirje sociale dhe siguri më të madhe në komunitet (shkallë më të ulët të kriminalitetit etj.).
- Uljen e barrës së Buxhetit të Shtetit për mirëqenien dhe kujdesin, si rezultat i treguesve të mësipërm.

Prandaj është e rëndësishme të garantojmë që fëmijët të regjistrohen në shkollë dhe t'i mbështesim fort ata që të përfundojnë jo vetëm klasën e 9-të, por t'i motivojmë edhe për vazhdimin e shkollës së mesme dhe më tej. Edhe pse kjo nuk është një përpjekje e lehtë, na takon të ndërmarrim një numër hapash për të siguruar ndjekjen e shkollës nga të gjithë fëmijët në moshë shkollore deri në përfundim të klasës së 9-të dhe të nxitim vijimin e mësimeve, duke krijuar një sistem të qëndrueshëm normash, procedurash, kriteresh e përgjegjësish institucionale dhe komunitare për reduktimin e braktisjes së shkollës dhe për rritjen e shkollës së arsimimit të fëmijëve dhe të të rinjve.

Frekuentimi i shkollës nga çdo fëmijë dhe parandalimi i braktisjes është përgjegjësi e të gjithë aktorëve, duke përfshirë edhe drejtorët e shkollave, mësuesit, nxënësit, prindërit/përfaqësuesit ligjorë të fëmijëve (këtej e tutje: "prindërit"), anëtarët e komunitetit, punonjësit e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, psikologët dhe punonjësit socialë. Bashkëpunimi mes aktorëve dhe koordinimi i veprimeve, me siguri, do të japë rezultate.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, IAVPAP-të, shkollat 9-vjeçare, prindërit, shoqatat, OJF të ndryshme, fondacione dhe grupe interesi kanë qenë dhe janë të interesuar vazhdimisht për gjetjen e shkaqeve të braktisjes shkollore. Të gjithë këta aktorë dhe të tjerë, veç e veç, por edhe në bashkëpunim e bashkëveprim me njëri-tjetrin, pas studimit të kësaj dukurie, ndërmarrin në vijimësi hapa dhe veprime konkrete për reduktimin e braktisjes, në interes të fëmijëve dhe të të rinjve, për t'i arsimuar të gjithë, në mënyrë që të gjithë të mund të integrohen në shoqërinë demokratike. Vetëm duke u përfshirë në sistem, nxënësit mund të arrijnë zhvillimin intelektual, fizik, social dhe estetik dhe do të aftësohen të mendojnë në mënyrë të pavarur, kritike dhe krijuese, duke iu përshtatur ndryshimeve. Vetëm kështu ata kanë shanse të barabarta për arsimim. Arsimi ndikon që fëmijët të mund të zhvillojnë vetëbesim dhe shpirt bashkëpunimi duke e aftësuar fëmijën të jetë i gatshëm të ofrojë përpjekjet e tij jo vetëm për mirëqenien vetjake, por për përparimin, lirinë dhe demokracinë e vendit e më gjerë.

Në vitet 2006-2008, Ministria e Arsimit dhe Shkencës (sot MASR) kreu një studim për analfabetizmin. Në kuadër të këtij studimi, braktisja shkollore ishte në qendër të analizave dhe objekt i një plani veprimi, i cili u bë edhe më konkret e më gjithëpërfshirës në dhjetor 2009, duke integruar veprimtari që shtriheshin deri në vitin 2013, me objektiv reduktimin në zero të dukurisë në fjalë.

Po të shohim shifrat e braktisjes shkollore, vërejmë se:

Para viteve '90 të shekullit të kaluar, braktisja shkollore ka qenë në tregues që kanë ardhur në ulje nga viti në vit. Kështu, nga 1.42 për qind që ka qenë në vitin shkollor 1983-1984, në vitin shkollor 1987-1988 gati është përgjysmuar, duke zbritur në 0.76 për qind. Shkolla braktisej kryesisht nga nxënës të klasave të larta të arsimit 8-vjeçar, kurse numri i nxënësve braktisës në klasat I-IV ishte i papërfillshëm. Gjithashtu, shumë pak kontingjente dilnin jashtë detyrimit shkollor, d.m.th. mbushnin moshën 16 vjeç, pa mbaruar ciklin e ulët (arsimin fillor). Nisur nga ky fakt, analfabetizmi konsiderohej se nuk ekzistonte të paktën në moshat 20-40 vjeç.

Gjatë viteve '90, braktisja e shkollës rezultoi në tregues më të lartë, të paparashikuar. Modelet negative të pasurimit të shpejtë ndikuan natyrshëm te nxënësit që nuk ishin të suksesshëm apo që kishin vështirësi në të nxënë. Këtij mentaliteti iu shtuan dhe indiferentizmi për sensibilizimin e komunitetit për rolin dhe domosdoshmërinë e shkollimit, si dhe neglizhencat për zbatimin e ligjit për arsimin e detyrueshëm. Në këto vite vërehet një rritje e numrit të djemve që linin shkollën, duke zbutur raportin djem/vajza, i cili më parë ishte në përpjesëtim të zhdrejtë. Ndërkohë, shkollën e braktisën një numër i madh nxënësish që në bankat e arsimit fillor (lanë mësimet ose nuk u regjistruan as në klasën e parë). Kjo kategori fëmijësh përbënte kontingjentet me mundësi më reale për t'u kthyer në analfabetë, pasi ata ose mbeteshin fillestarë në lexim-shkrim, ose nuk arrinin të përvetësonin as shkronjat e alfabetit. Sipas statistikave zyrtare të Ministrisë, në vitin 2009 braktisja e shkollës në arsimin bazë ishte 0.81 për qind, nga 1.81 për qind që ka qenë në vitin 2003. Analiza e treguesve paraqet një situatë jo të favorshme në drejtim të ndërprerjes së mësimave në klasat VI-IX të arsimit bazë (1.95 për qind). Të vlerësuar në kohë, treguesit e braktisjes shkollore kanë pasur tendencë të ulen. Kështu, në vitin shkollor 2014-2015, braktisja shkollore ishte 0.57 për qind (në arsimin fillor 0.46 për qind; në arsimin e mesëm të ulët 0.70 për qind); në vitin shkollor 2015-2016, 0.55 për qind (në arsimin fillor 0.47 për qind; në arsimin e mesëm të ulët 0.63 për qind); në vitin shkollor 2016-2017, 0.57 për qind (në arsimin fillor 0.52 për qind; në arsimin e mesëm të ulët 0.64 për qind); në vitin shkollor 2017-2018, 0.48 për qind (në arsimin fillor 0.46 për qind; në arsimin e mesëm të ulët 0.51 për qind). Megjithatë, braktisja e shkollës nga nxënësit e shtresave më në nevojë mbetet problem.

Nisur nga problematikat e hasura dhe nga politikat arsimore qeveritare, Ministria vlerësoi si përparësi nevojën e bashkëpunimit me ministri të tjera për të ndërmarrë nismën "Çdo fëmijë në shkollë" dhe, me mbështetjen e UNICEF-it, u arrit Marrëveshja e Bashkëpunimit e vitit 2013 (M4M). Në fillim të vitit 2015, tri ministri (MAS, MPB dhe MSh), për zbatimin e Marrëveshjes së katër ministrive, me mbështetjen e UNICEF-it dhe në partneritet me Observatorin për të Drejtat e

Fëmijëve dhe të Rinjve, arritën hartimin dhe nënshkrimin e Urdhrit të Përbashkët 3-Ministror (U3M). Marrëveshja e Bashkëpunimit e vitit 2013 ishte me afat 4-vjeçar. Kjo ishte përpjekja e parë sistematike e Shqipërisë për t'iu përgjigjur çështjes së fëmijëve jashtë shkollës. Këto dokumente ligjore kontribuan në ndërtimin e një mirëkuptimi të përbashkët brenda autoriteteve rajonale, bashkive dhe shkollave lokale, për kompleksitetin e faktorëve të përfshirë në çështjen e fëmijëve jashtë shkolle dhe nevojën për njohjen, përtej faktorëve personal dhe familjar, e përgjegjësive të sistemit (arsimit, shëndetësisë, mbrojtjen e fëmijëve, mbrojtjen sociale) kur nuk i përgjigjet në mënyrë e duhur këtyre nevojave. Nënshkrimi i këtyre dokumentave ligjore, u shoqërua më udhëzues dhe manuale për zbatimin më në detaje të roleve dhe përgjegjësive të aktorëve të ndryshëm. Këto dokumente kontribuan në mënyrë direkte në ofrimin e:

- Praktikës së punës për manualin e roleve të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e U3M;
- Praktikës së trajnimeve ndërsektoriale ndërmjet stafeve të institucioneve shkollore dhe institucioneve lokale që i angazhohen detyrime nga nënshkrimi i U3M;
- Guidave dhe udhëzimeve për mentorimin e praktikave më të mira të shkollave mbi reduktimin e braktisjes shkollore dhe intergrimin e fëmijëve jashtë shkolle;
- Praktikës së trajnimeve të aktorëve brenda institucioneve arsimore të arsimit bazë mbi sigurimin e frekuentimit të rregullt dhe përfundimit të arsimit bazë nga çdo fëmijë;
- Praktikës së punës për nxjerrjen e të dhënave nga tregues ndërkombëtarë të sistemit arsimor;
- Praktikës së kryqëzimit të listave nga burime të ndryshme me qëllim evidentimin e fëmijëve jashtë shkolle;
- Praktikës së bashkëpunimit ndërinstytucional për intensifikimin e punës në drejtim të çështjes së fëmijëve jashtë shkolle.

Marrëveshja e Bashkëpunimit e vitit 2013 pushoi së vepruari në korrik 2017. Edhe pse puna për reduktimin e braktisjes përmes identifikimit dhe regjistrimit në shkollë të çdo fëmije në moshën e detyrimit shkollor vazhdoi mbështetur në U3M, ndihej nevoja e një marrëveshjeje të re të bashkëpunimit ndërministror. Kjo u bë e mundur në vitin 2018, kur MASR-ja, MB dhe MShMS-ja nënshkruan Marrëveshjen e Bashkëpunimit protokolluar në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR) me nr. 7522 prot., datë 12.07.2018, në Ministrinë e Brendshme (MB) me nr. 8649 prot., datë 22.10.2018 dhe në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS) me nr. 6084 prot., datë 23.10.2018, "Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor".

Udhëzuesi mbështet zbatimin e M3M dhe U3M, përmes ofrimit të përkrahjes institucioneve arsimore parauniversitare, dhe hartimin e planeve të veprimit në nivel shkolle dhe ZVA-je për adresimin e problemit të fëmijëve jashtë shkolle (fëmijëve braktisës, fëmijëve të paregjistruar asnjëherë në shkollë, fëmijëve me probleme sociale, fëmijëve me aftësi të kufizuara, fëmijëve të paregjistruar në gjendjen civile, fëmijëve vulnerabël etj.).

Trajnimi i drejtuesve të institucioneve arsimore dhe i aktorëve të tjerë synon të rrisë ndërgjegjësimin në lidhje me rolin e shkollave dhe komuniteteve në sigurimin e regjistrimit, mbajtjes në shkollë dhe pjesëmarrjes / frekuentimit të rregullt nga të gjithë fëmijët deri në përfundim të arsimit bazë. Për ta bërë këtë, shkolla dhe komuniteti duhet të sigurojnë mjete dhe strategji konkrete.

MASR-ja synon gjithëpërfshirjen dhe sigurimin e të drejtës së arsimit cilësor për të gjithë. Zbatimi i nismës "Çdo fëmijë në shkollë", tashmë, po ndryshon dukshëm situatën dhe shifrat e numrit të fëmijëve që e lënë shkollën, do të vazhdojnë të shënojnë rënie.

II. MIRËNJOHJE

Përditësimi i këtij Udhëzuesi kaloi nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm pune, me takime konsultative si dhe me përfaqësim ndërinstitucional të nivelit qendror dhe vendor. Ky Udhëzues mundësohet falë vëmendjes dhe mbështetjes së zyrës së UNICEF-it në Shqipëri, si dhe bashkëpunimit të zyrës së Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve për të realizuar këtë dokument pune për interes dhe në dobi të tri ministrive nënshkruese të M3M-së dhe strukturave vartëse të tyre.

Një falënderim dhe mirënjohje e veçantë u drejtohet tri ministrive që kanë bashkëpunuar në këtë proces, konkretisht: Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme.

Një falënderim shkon për ekspertët lokalë për bashkëpunimin e hapur dhe mbështetjen e treguar nga strukturat arsimore në rajone të ndryshme të vendit.

Praktika e shkëmbyer ndërmjet tri ministrive dhe strukturave vartëse të tyre mundësoi zyrtarizimin e aksioneve ndërministrorë për identifikimin e fëmijëve jashtë shkolle apo në rrezik braktisjeje në të gjithë vendin. Pilotimi i kësaj praktike, si fillim në Bashkinë Durrës, dhe më pas në Bashkitë Korçë, Shkodër dhe Lezhë u realizua falë angazhimit të specialistëve të ish-DAR, të drejtorëve të dhjetë shkollave të përzgjedhura për pilotim dhe mësuesve, prindërve dhe nxënësve që u bënë pjesë e këtij procesi, të cilët meritojnë një falënderim të veçantë.

Falënderim i posaçëm shkon për titullarët e institucioneve të mëposhtme dhe anëtarët e grupeve lokale të punës për fëmijët jashtë shkolle, të cilët kanë bashkëpunuar ndërsektoralisht për çështjen e identifikimit dhe regjistrimit në shkollë të të gjithë fëmijëve, si:

- Institucionin e Prefektit Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër.
- Zyrat vendore arsimore Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër.
- Bashkitë Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër.
- Njësitë për mbrojtjen e fëmijës në bashkitë Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër.
- Komisarariatet e Policisë Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër.
- Drejtoritë e shëndetit publik Durrës, Korçë, Lezhë dhe Shkodër.

Falënderojmë profesorin z. Stavri Llambiri për kontributin e paçmuar në hartimin e metodologjisë së matjes së braktisjes shkollore dhe nxënësve në rrezik braktisjeje dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën aktive në të gjitha trajnimet e takimet e punës të zhvilluara gjatë pilotimit të nismës.

Falënderime të veçanta i shkojnë ekipit të punës për kontributin dhe ekspertizën e ofruar në përditësimin dhe finalizimin e këtij Udhëzuesi, në veçanti znj. Zamira Gjini (MASR), znj. Rozalba Merdani (MASR), znj. Ornela Koleka (MASR), znj. Bajame Allmeta (MASR), znj. Shqiponja Lamçe (MASR), znj. Ardiana Janku (MShMS), znj. Ilsa Dede (MShMS), znj. Alma Tandili (AShMDF), znj. Rovena Voda (MB), z. Edmond Gjoleka (MB), znj. Julia Done (MB), znj. Elma Tërshana (Observatori), znj. Eridjona Vallja (Observatori).

Udhëzuesi i ri u përpunua dhe u redaktua nga z. Besnik Rama, specialist në MASR, të cilin e falënderojmë për kontributin dhe punën profesionale edhe gjatë trajnimeve e monitorimit të zbatimit të nismës.

Grupi i specialistëve falënderon UNICEF-in, që vazhdon të jetë partner në zbatimin e nismës, dhe veçanërisht z. Roberto de Bernardi për mbështetjen, si edhe znj. Mirlinda Bushati për kontributin e dhënë.

III. HYRJE

III.1. Kujt i shërben ky Udhëzues?

Ky dokument udhëzon aktorët e përfshirë në përbushjen e M3M dhe të U3M për realizimin e nismës “Çdo fëmijë në shkollë”. Disa nga mjetet dhe strategjitë që pritet të japin rezultate efektive në realizimin e nismës, janë:

- Pajtueshmëria dhe përbushja e kërkesave në të ardhmen për të dhënat në arsim nga organiza ndërkombëtare statistikash, si EUROSTAT dhe ISU.
- Monitorimi i procesit dhe i veprimtarive drejt zvogëlimit të numrit të FJSA-ve për arritjen e pikësnyimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, si objektivi i BE-së: Më pak se 20 për qind “largim të hershëm nga shkolla” deri në vitin 2020 dhe objektivat e rinj të zhvillimit pas vitit 2020.
- Analiza e shkaqeve të largimit nga shkolla dhe vendimmarrjet në përputhje me dukuritë e braktisjes, në mënyrë që kjo analizë të ndihmojë posaçërisht në sigurimin se ndërhyrjet janë përmirësuar dhe përshtatur për të përbushur nevoja specifike, për të parandaluar braktisjen e hershme të shkollës dhe për të reduktuar numrin e fëmijëve jashtë sistemit arsimor.
- Përmirësimi i efikasitetit dhe zvogëlimi i kostove dhe i kërkesave të stafit duke gjeneruar automatikisht treguesit që nevojiten/kërkohen më shpesh dhe të dhënat e lidhura me to.

III.2. Çfarë synojmë të arrijmë?

Nëpërmjet trajnimit në nivel bashkie dhe në institucionet arsimore parauniversitare synohet që të rritet ndërgjegjësimi për rolin që kanë shkollat dhe komunitetet në sigurimin e regjistrimit, mbajtjes dhe pjesëmarrjes / frekuentimit të rregullt për të gjithë fëmijët në moshë shkollore, duke u siguruar komuniteteve të shkollave mjete dhe strategji konkrete për ta bërë këtë.

Më konkretisht, trajnimi synon:

- Informimin e aktorëve të komunitetit shkollor për rolet dhe përgjegjësitë e tyre në lidhje me identifikimin e fëmijëve që nuk regjistrohen ose nuk shkojnë në shkollë dhe të atyre në rrezik braktisjeje.
- Futjen dhe zbatimin e një mekanizmi të thjeshtë për të identifikuar fëmijët në rrezik braktisjeje.
- Sigurimin e strategjive të thjeshta dhe të mjeteve për komunitetet e shkollave për të kontribuar dhe për të adresuar situatat konkrete të fëmijëve që janë jashtë shkolle ose në rrezik braktisjeje.
- Përfshirjen e gjithë aktorëve në proces dhe sigurimin e bashkëpunimit në nivel horizontal e vertikal për krijimin e bazës së të dhënave, për ruajtjen e kësaj baze të dhënash, për harmonizimin e strategjive dhe planeve të veprimit që na shpion drejt qasjes më të mirë për realizimin konkret dhe konsolidimin e nismës “Çdo fëmijë në shkollë”.

III.3. Target-grupet që do të trajnohen

- Drejtorët e shkollave,
- mësuesit kujdestarë klase dhe mësuesit e lëndëve,
- psikologët dhe punonjësit socialë të shkollave,
- prindërit dhe anëtarët e komunitetit,
- përfaqësuesit e IAVPAP-ve,
- përfaqësuesit e QSh-ve,
- përfaqësuesit e komisariateve të policisë,
- personat përgjegjës të nënndarjeve administrative,
- njësitë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve,
- punonjësit socialë etj.

III.4. Informacion për trajnimin

Trajnimi i propozuar parashikohet të zgjasë dy ditë. Trajnimi është hartuar dhe realizohet nga Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve, me mbështetjen e UNICEF-it.

Trajnerët janë të lirë të përshtatin përmbajtjen e këtij Udhëzuesi me kontekstin dhe kapacitetin e shkollave pilot. Nuk mund të bëhen ndryshime të mëdha në qasjen e përgjithshme të trajnimit pa miratimin paraprak nga UNICEF-i.

Punonjësit e IAVPAP-ve dhe të institucioneve e të organeve të ndryshme në nivel vendor ftohen në trajnim për t'u informuar për rëndësinë e procesit, për detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, mbështetja e të cilëve është e domosdoshme dhe ka rëndësi të veçantë.

IV. FËMIJËT JASHTË SHKOLLE

IV.1 . Cilat janë grupet e rrezikuara të fëmijëve?

Bazuar në literaturë, grupet më të rrezikuara të fëmijëve që mbeten jashtë shkolle, janë fëmijët me aftësi të kufizuara, fëmijët e kthyer nga emigracioni, fëmijët me probleme të ndryshme sociale, fëmijët e pakicave romë dhe egjiptiane, vajzat, fëmijët që punojnë për t'u ardhur në ndihmë familjeve të tyre, fëmijët viktime të dhunës dhe të trafikimit, të mbijetuarit e abuzimit seksual, fëmijët e braktisur, fëmijët e paregjistruar në gjendjen civile etj.

Fëmijët, të cilët nuk regjistrohen dhe nuk vijnë në shkollë ose e kanë braktisur atë, mund të jenë të moshave të ndryshme, duke filluar që nga moshën gjashtëvjeçare e arsimi fillor deri në moshën e detyrimit shkollor, që është moshën gjashtëmbëdhjetëvjeçare.

Për të parandaluar braktisjen e shkollës, institucionet arsimore duhet t'u kushtojnë vëmendje të veçantë fëmijëve në rrezik të braktisjes së shkollës. Në përgjithësi, këta janë fëmijë të cilët mungojnë shpesh në shkollë, ndonjëherë për periudha të gjata kohore, për shkak të sëmundjes apo rolit që ata kanë në përkujdesjen e motrave ose vëllezërve të vegjël, rolit për t'u angazhuar në punë shtëpiake apo bujqësore, shoqërimin me persona më të rritur etj.

Fëmijët në rrezik të braktisjes së shkollës shpeshherë "nuk duken". Këta fëmijë mund të jenë, gjithashtu, fëmijë që u ekspozohen faktorëve të ndryshëm të rrezikut, faktorë që i "nxitin" ata edhe më shumë në braktisjen e shkollës sesa moshatarët e tyre.

Përveç rolit parandalues, gjatë punës së institucioneve arsimore dhe grupeve të interesit për menaxhimin e dukurisë së braktisjes, vëmendje e kujdes i posaçëm u duhet kushtuar tri kategorive kryesore të fëmijëve që nuk shkojnë apo që mungojnë shpesh në shkollë:

1. Fëmijët e moshës shkollë që nuk janë regjistruar asnjëherë dhe nuk e vijnë shkollën.
2. Fëmijët në rrezik për ta braktisur shkollën.
3. Fëmijët e moshës shkollë që e braktisin shkollën para përfundimit të klasës së 9-të.

IV.2. Cilët janë faktorët e rrezikut për mosregjistrimin, mosvijimin dhe braktisjen e shkollës nga fëmijët?

Mund të evidentojmë një sërë shkaqesh e faktorësh që i pengojnë fëmijët të regjistrohen në shkollë. Disa prej tyre janë: gjendja e rëndë ekonomike; probleme shëndetësore dhe aftësia e kufizuar; niveli i ulët arsimor i prindërve; largësia e shkollave nga qendrat e banuara; emigracioni i prindërve; lëvizjet demografike të popullsisë; mentaliteti; gjakmarrja; probleme sociale; shfrytëzimi i fëmijëve për punë brenda e jashtë familjes; papërgjegjshmëria e mësuesve dhe e drejtuesve të shkollave; puna e pakualifikuar dhe e pamjaftueshme me prindërit për të regjistruar fëmijët në shkollë; moszbatimi i akteve ligjore e nënligjore në fuqi; mosfrekuentimi i kopshtit nga parashkollorët (është provuar tashmë rëndësia e edukimit parashkollor, pasi e parapërgatit fëmijën për t'u regjistruar në shkollë, së pari, duke i zgjuar interesin për jetën dhe punën në grup etj.); rrethanat familjare, ekonomike dhe sociale të prindërve romë e egjiptianë etj. Siç dallohet lehtë, janë thuajse po ato shkaqe që ndikojnë në braktisjen e shkollës nga nxënësit në nivele e klasa të ndryshme dhe në periudha të ndryshme të vitit shkollor.

Disa prej faktorëve kryesorë janë:

○ Faktorët individualë

Sëmundjet e ndryshme (të përkohshme apo kronike); aftësitë e kufizuara (fizike, mendore etj.); martesat e hershme, kryesisht të vajzave; mungesa e përkrahjes dhe e mbështetjes së fëmijës nga familja; përfshirja në dukuri të ndryshme negative; përdorimi i duhanit, i alkoolit apo i narkotikëve; qasja individuale ndaj shkollës etj.

Një kategori të fëmijëve që braktisin shkollën, përbëjnë fëmijët me aftësi të kufizuara. Në Rregulloren për institucionet arsimore parauniversitare, që mbështet ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, theks i veçantë i vihet përfshirjes në arsimin publik të të gjithë fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe, shprehimisht, theksohet: "Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të

specializuara për ta është përgjithësisht e përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore". Edhe pse legjislacioni shqiptar garanton të drejtën e plotë për arsim publik të çdo fëmije, pavarësisht aftësisë së kufizuar, të shumta janë problemet që ekzistojnë lidhur me aksesin dhe përfshirjen e fëmijëve në shkollë, të cilat lidhen ngushtë me mentalitetin, praktikën e mësimdhënies, qasjen gjithëpërfshirëse që duhet të ketë shkolla etj.

Pavarësisht ekzistencës së shkollave speciale dhe funksionimit të arsimit special, në të gjitha zonat e vendit numërohen jo pak fëmijë me aftësi të kufizuara. Në mars të vitit 2010, MASH-i arriti të sigurojë të dhënat më të përafërta për numrin e nxënësve me AK brenda sistemit. MARS-ja, shkollat dhe shoqata e fondacione të ndryshme, OJF, në kuadrin e Strategjisë Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara kanë realizuar hapa konkretë lidhur me arsimimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Përveç funksionimit të shkollave speciale, që aktualisht frekuentohen nga mbi 660 nxënës me AK, edhe shkollat e zakonshme mbajnë në vëmendje këtë kategori fëmijësh, duke programuar punë të diferencuar dhe të specializuara, me synim integrimin e plotë në shkollë. Gjatë vitit shkollor 2018-2019, arsimin parauniversitar e frekuentuan 4683 fëmijë me AK (489 arsimin parashkollor, 3664 arsimin bazë dhe 530 arsimin e mesëm të ulët). Duke filluar nga vitit shkollor 2014-2015 e në vazhdim, në sistem shërbejnë dhe mësues ndihmës. Kështu, gjatë vitit shkollor 2018-2019 punuan 983 mësues ndihmës (933 mësues ndihmës në shkollat publike dhe 50 në shkollat private).

○ Faktorët familjarë

Mungesa e kujdesit të mjaftueshëm prindëror (pa të dy prindërit ose pa njërin prind dhe shkurorëzimet); niveli i arsimimit të prindërve; niveli kulturor i familjeve; mungesa e bashkëpunimit të familjes me komunitetin (sidomos i familjeve të migruara); roli i fëmijëve për të mbajtur familjen me punësim të përkohshëm apo për t'u kujdesur për motrën, vëllain më të vogël etj.

Zakonisht, prindër të cilët nuk e kanë pasur të mundur të frekuentojnë arsimin bazë, e kanë të vështirë ta kuptojnë rëndësinë që ka arsimimi, kështu që shpesh bëhen pengesë për ndjekjen e shkollës nga fëmijët e tyre.

Prindër të shkurorëzuar, për shkak të problemeve lidhur me ndarjen, e kanë të vështirë të menaxhojnë marrëdhëniet ndërpersonale dhe mund të përfshijnë emocionalisht edhe fëmijët e tyre. Këta të fundit, si pasojë e konflikteve, mund të përjetojnë depresion dhe vëmendja e tyre largohet nga shkolla deri në braktisjen e saj.

Humbja e njërit prej prindërve, apo e të dyve, disfavorizon përkushtimin e fëmijëve ndaj mësimëve dhe shkollës. Zakonisht, fëmijët me një prind, sidomos ata pa asnjë prind, jo vetëm që vuajnë mungesën e prindit, por ndeshen me vështirësi të mëdha ekonomike dhe sociale, për pasojë mund ta braktisin shkollën, nëse ndaj tyre mungon një përkujdesje e veçantë nga të afërmit, institucionet shtetërore dhe shoqëria.

Në shumë zona rurale të vendit tonë, mentaliteti i prindërve për arsimimin e vajzave ende përbën një problem social. Familje të zonave rurale, si dhe prindër egjiptianë dhe romë, për shkak të mentalitetit, shpesh bëhen pengesë për shkollimin e vajzave, duke i ndaluar ato të vijnë në mësimet deri në përfundim të arsimit të detyruar. Treguesit e braktisjes shkollë flasin se numri më i madh i vajzave që shkëputen nga shkolla, u përket kryesisht klasave VI-IX. Prindërit kanë tendencë t'i ndalojnë vajzat e tyre të frekuentojnë shkollën në momentin që ato hyjnë në pubertet ose adoleshencë. Në bisedë me prindërit e vajzave, ata nxjerrin justifikime nga më të ndryshmet për të shmangur përgjegjësinë prindërore: kërkojnë për vajzat garanci nga shkolla; kërkojnë mbrojtjen e vajzave nga keqtrajtimi, nga abuzime dhe përdhunime "që mund t'u ndodhin" në shkollë apo jashtë saj, rrugës për në shkollë apo gjatë kthimit për në shtëpi pas mësimëve; kërkojnë sigurimin e transportit falas, pavarësisht largësisë së shkollës nga shtëpia, madje duan edhe t'i shoqërojnë ato në vajtje-ardhje. Martesa në mosha të hershme (sidomos te vajzat romë), si dhe angazhimi në punë kryesisht brenda familjes, në shumicën e rasteve për t'u shërbyer motrave e vëllezërve më të vegjël, janë dy arsye të tjera pse prindërit i shkëpusin vajzat nga shkolla pa mbaruar arsimin e detyruar.

○ Faktorë shkollorë

Pozita gjeografike e shkollave (rreziqet gjatë udhëtimit, sidomos në zonat e thella malore, mungesa e infrastrukturës rrugore); marrëdhëniet mësues-nxënës dhe anasjelltas; marrëdhëniet

nxënës-nxënës; konfliktet, dhuna (*bulizmi*¹ dhe *cyberbulizmi*²); mungesa e shërbimeve të mjaftueshme dhe të domosdoshme profesionale në trajtimin e problemeve e të konflikteve brenda shkollës; mungesa e një rregulloreje të rreptë për mbrojtjen e fëmijëve brenda shkollës; mungesa e punonjësit për kujdesin ndaj fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre (psikolog ose punonjës social); raporti i numrit të fëmijëve për psikolog dhe punonjës social shumë i madh; niveli i pamjaftueshëm dhe i munguar i bashkëpunimit të shkollës me komunitetin dhe me shërbimet e tjera vendore ndikojnë ndjeshëm në braktisjen e shkollës, sidomos nga fëmijët vulnerabël.

Vitet e fundit, shërbimi arsimor është përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme. Institucionet parashkollore dhe ato shkollore janë forcuar në formë e në përmbajtje; po zbatohet një kurrikul bashkëkohore për të mësuarit me bazë kompetencat, më afër nevojave e interesave të nxënësve të sotëm - qytetarë të nesërm; janë rikonstruktuar kopshte e shkolla ekzistuese dhe janë ndërtuar e po ndërtohen kopshte dhe shkolla të reja me parametra bashkëkohorë; përparësi kanë marrë punësimi i mësuesve me arsim përkatës dhe në përputhje me profilin, formimi dhe zhvillimi profesional i mësuesve dhe i drejtuesve të arsimit etj. Megjithatë, probleme që lidhen drejtpërdrejt me përmbushjen e misionit, të synimeve dhe të funksioneve të sistemit arsimor parauniversitar, reflektojnë dhe në dukurinë e braktisjes shkollore, pasi janë të lidhura ngushtë me forcimin e interesit ose, e kundërta, me humbjen e interesit për shkollën nga ana e nxënësve dhe e prindërve të tyre. Ashtu si para viteve '90 të shekullit të kaluar, edhe gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, mbetja në klasë ka qenë dhe mbetet një nga shkaqet që nxënësit braktisin shkollën. Nxënësit përsëritës ndihen keq dhe vetëbesimi i tyre ulet, pasi hasin vështirësi në përgatitjen e tyre dhe përballen me dështime të njëpasnjëshme, pasi janë kontingjente të braktisjes së fshehtë. Këta nxënës e kanë të vështirë frekuentimin e rregullt të mësimit, lënë orët e mësimit dhe mungojnë shpesh, derisa një ditë e braktisin shkollën. Shpeshherë, nxënësit përsëritës janë fëmijë të cilët kanë probleme me të nxënit dhe që nuk janë diagnostikuar asnjëherë nga psikologu. Këta fëmijë mësojnë ndryshe dhe, për këtë, sugjerohet të zhvillohen plane edukative individuale që t'u vijnë në ndihmë në kohë. **Psikologët e shkollave dhe mësuesit kujdestarë kanë detyrë t'i identifikojnë këta nxënës dhe t'i mbështesin me planet edukative duke vendosur objektiva afatshkurtër dhe afatgjatë.**

Në pikën 3 të nenit 18 të ligjit nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" përkrahën një sërë detyrimesh të MASR-së dhe të institucioneve në varësi të saj:

"Ministria përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si autoritet publik përgjegjës, si dhe njësitë arsimore vendore marrin masa konkrete, me qëllim që:

- a) të mundësojnë aksesin e fëmijës në arsimin parashkollor, si dhe arsimin e detyrueshëm falas për të gjithë fëmijët, edhe në rastet kur fëmijët mund të kenë kaluar moshën për arsimin e detyrueshëm, por kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë;
- b) të zhvillojnë, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë, programe edukimi për prindërit, përfshirë programe për parandalimin e dhunës në familje;
- c) të organizojnë plane mësimore të veçanta për fëmijën që nuk arrin nivelet e duhura që synon programi mësimor, me qëllim parandalimin e largimit nga shkolla para kohe të fëmijës;
- ç) të organizojnë plane mësimore të veçanta edukimi për fëmijët që braktisin shkollën ose që nuk e kanë frekuentuar asnjëherë apo për fëmijët që kthehen nga qëndrimi jashtë vendit, ose pranë institucioneve joshkollore, me qëllim integrimin e tyre në sistemin kombëtar të edukimit;
- d) të mbikëqyrin të drejtën e fëmijës për t'u çlodhur, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në aktivitete kulturore e artistike;
- dh) të marrin masa konkrete për ofrimin e shërbimeve sociale brenda mjediseve të shkollës, si ushqim, transport e të tjera, me qëllim parandalimin e braktisjes së shkollës për arsye ekonomike;

¹ Ngacmimi, frikësimi, kërcënimi, kanosja

² Përdorimi i komunikimit elektronik në mënyrë tipike, duke i dërguar një personi mesazhe me përmbajtje frikësuese apo kërcënuese. Fëmijët mund të jenë viktimë të cyberbulizmit.

- e) të krijojnë kushtet e nevojshme, me qëllim rritjen e cilësisë së arsimit, nëpërmjet kurrikulave, mjeteve mësimore, infrastrukturës së përshtatshme, si dhe të vlerësimit periodik të personelit mësimor;
- ë) të sigurojnë burime të mjaftueshme dhe të përshtatshme njerëzore, materiale e financiare për të siguruar arsimimin cilësor të fëmijës;
- f) të ndërmarrin veprime konkrete për të garantuar të drejtën e arsimit të fëmijës që i përket grupeve ose rajoneve me mangësi të konsiderueshme edukimi ose që është në situata të vështira sociale, ekonomike ose gjendje fizike apo mendore të veçantë, ose që lidhen me aspekte të gjinisë, besimit fetar ose praktikave kulturore, ose që janë pjesë e një grupi kulturor etnik ose vijnë nga një situatë migratore;
- g) të ngrenë mekanizma efikasë për parandalimin, trajtimin brenda shkollës dhe raportimin tek autoritetet përgjegjëse të situatave të dhunës, duke përfshirë edhe ato ndërmjet vetë fëmijës brenda shkollës (bulizmi);
- gj) të parashikojnë dhe zbatojnë sanksione të përshtatshme për personelin arsimor, në rastet kur ai lejon, nxit, toleron ose nuk raporton veprime të dhunshme ose ngacmimi të fëmijës në institucionet e edukimit, sipas këtij ligji.
- h) të marrin masa për identifikimin e fëmijës në rrezik për të braktisur shkollën ose të atij që e ka braktisur atë, duke koordinuar veprimet me autoritetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim mbajtjen ose kthimin e tij në shkollë.”

Ndërsa në pikën 4 të këtij neni sanksionohet se:

“Në rastet kur identifikohen fëmijë që nuk frekuentojnë arsimin e detyrueshëm, për shkak të mosregjistrimit në zyrat e gjendjes civile ose arsye të tjera, punonjësi i njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit, pranë pushtetit vendor merr masa të menjëhershme për regjistrimin të fëmijës në shkollë, sipas legjislacionit në fuqi.”

Në pikën 5 të këtij neni sanksionohet se: “Gjatë procesit mësimor e edukativ fëmija trajtohet me dinjitet nga mësuesit dhe personeli, si dhe informohet për të drejtat e tij dhe mjetet e ushtrimit të tyre, sipas këtij ligji. Ndëshkimi trupor i fëmijës si dhe çdo formë tjetër e dhunës gjatë procesit të edukimit janë të ndaluara”.

Ndërsa në pikën 6 sanksionohet se: “Fëmija ka të drejtë të ankohet ndaj vlerësimeve të dijeve të tij, sipas kritereve të parashikuara në legjislacionin në fuqi për arsimin parauniversitar.”

Një akt mjaft pozitiv është nxjerrja e Udhëzimit të MASR-së Nr. 17, datë 09.05.2018 “Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimimin me kohë të pjesshme në arsimin bazë”, i cili lehtëson procedurat e regjistrimit/rikthimit në shkollë të fëmijëve që, për rrethana të përcaktuara në udhëzim, nuk e kanë ndjekur arsimin bazë për të paktën dy vite shkollore, e kanë braktisur shkollën, identifikohen si të paregjistruar në shkollë ose janë fëmijë në situatë rruge, si dhe krijon lehtësira për ndjekjen e arsimit bazë me kohë të pjesshme nga të rriturit që nuk kanë arritur ta mbarojnë arsimin bazë me kohë të plotë, duke u dhënë mundësinë që, ashtu si fëmijët në arsimin bazë me kohë të plotë, edhe ata të mund të pranohen në një apo dy klasa më të larta se klasa për të cilën zotërojnë dokument shkollor (apo pretendojnë se kanë formimin shkollor për t’u pranuar në klasa më të larta, në mungesë të dokumentit shkollor), duke u provuar nga një komision të ngritur në shkollë. Nga lehtësirat që krijohen me udhëzimin e ri përfitues janë dhe fëmijët, të rinjtë dhe të rriturit romë dhe egjiptianë.

Nga studimet është vënë re se ushtrimi i dhunës në shkollë çon në braktisjen e shkollës nga nxënësit të cilët janë shpesh viktimat e dhunës së ushtruar nga bashkëmoshatarët, por edhe të atyre që ushtrojnë dhunë. Këta të fundit kanë tendencë të përfshihen në banda kriminale adoleshentesh, të cilat përfshihen në vjedhje apo krime të tjera. Keqtrajtimi sistematik i nxënësit nga mësues-i/-it, por dhe nga moshatarët apo nxënësit më të rritur, bën që fëmija të mund të kalojë periudha depresioni dhe të largohet nga shkolla për të mos u kthyer më. **Mungesa e atmosferës së ngrohtë miqësore, bashkëpunuese e bashkëvepruese në shkollë dhe në familje ndikojnë negativisht në formimin e personalitetit të fëmijës.**

Mungesa e kushteve të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe klima jo e përshtatshme në klasë e në shkollë bëhen shkak për braktisjen e shkollës nga nxënës të ndryshëm. Një mjedis shkollor ku mungojnë orenditë e nevojshme, apo ku ato janë të amortizuara, ku mungon ngrohja në dimër dhe freskimi në muajt e tjerë etj., nuk i tërheq nxënësit dhe nuk ngjall tek ata interes e respekt për shkollën. Të njëjtën gjë përjetojnë nxënësit dhe kur në klasë e në shkollë mungon atmosfera e ngrohtë dhe klima bashkëpunuese.

Edhe braktisja e fshehtë favorizon braktisjen shkollore. **Lënia në hije, duke mos i aktivizuar të gjithë nxënësit**, sidomos ata me vështirësi në të nxënë, i shkurajon nxënësit, i bën ata të humbasin besimin në aftësitë e tyre, të mbyllën në vetvete dhe të mbeten të papërfshirë edhe në veprimtari mësimore apo jashtëshkollore ku mund të shfaqin aftësi personale e interes për të nxënë. Nxënësit e braktisjes së fshehtë, për një motiv a për një tjetër, kthehen në kontingjente të braktisjes shkollore sepse, duke mos i angazhuar në punë, duke mos i përfshirë në aktivitetet e grupit apo të klasës, atyre u bëhet e mërzitshme shkolla dhe e padurueshme koha e qëndrimit në një kënd thuajse të papërfillur nga pjesa tjetër e auditorit.

Në nenin 68 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, sanksionohet se: “Mosregjistrimi dhe mungesat e paarsyeshme të fëmijës në mësim për më shumë se 25 për qind të orëve mësimore gjatë një viti shkollor vlerësohen si rast i neglizhencës prindërore dhe trajtohen në përputhje me ligjin nr. 10 347, datë 4.11.2010, “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.³

Neni 24, i ligjit të ri: “5. Në rast se një fëmijë, brenda moshës për të cilën parashikohet arsimi i detyrueshëm, shmang arsimimin, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të ndaluara, sipas ligjit, personeli arsimor njofton menjëherë prindin ose kujdestarin, si dhe njësinë e mbrojtjes së fëmijës, të cilët marrin masa të menjëhershme që fëmija të rikthehet në shkollë.”⁴

Moszbatimi nga njësitë e vetëqeverisjes vendore i sanksioneve të përcaktuara për detyrimin shkollor ka pasur dhe vazhdon të ketë një ndikim të ndjeshëm në braktisjen shkollore nga nxënësit, pasi prindërit e fëmijëve që nuk e frekuentojnë dhe e braktisin shkollën, nuk vihen para përgjegjësisë ligjore dhe mbeten të pandëshkuar edhe nga ana financiare, pavarësisht se janë shkaktarë të mosarsimit të adoleshentit.

○ Faktorë socialë

Problemet sociale: varfëria e skajshme familjare, niveli i ulët i bashkëpunimit ndërinstitucional dhe me komunitetin, dukuritë negative brenda shoqërisë, lëvizjet e popullatës, migrimet etj., janë faktori me ndikimin më të ndjeshëm në braktisjen shkollore. Niveli arsimor i prindërve të fëmijëve, zhvillimi i ulët arsimor, lëvizjet demografike gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, emigracioni individual e familjar, prindërit e shkurorëzuar, dhuna në familje (dhuna në çift dhe ajo ndaj fëmijëve nga një prind apo nga të dy prindërit), humbja e njërit prej prindërve apo e të dyve, mentaliteti i prindërve për arsimimin e vajzave, ngujimi për shkak të gjakmarrjes apo hakmarrjes etj. janë shkaqet sociale kryesore që favorizojnë braktisjen shkollore në mjaft shkolla 9-vjeçare të zonave të ndryshme të vendit. Shumë nxënës braktisës, për pasojë të problemeve sociale, janë të tillë që në moshë fare të mitur, që 6 vjeç. Fëmijë nga familje të ndryshme, kryesisht romë dhe egjiptianë, por jo vetëm të tillë, mbeten pa u regjistruar në shkollë, i shmangen shkollës për shkak të zhvendosjes familjarisht nga një qendër banimi në një tjetër, për shkak të emigrimit të njërit prej prindërve, të të dy prindërve ose të gjithë familjes në vendet fqinje apo dhe më larg etj.

Ngujimi i familjeve për shkak të gjakmarrjes apo hakmarrjes lë pa arsimim fëmijë në fshatra të zonave të veriut e, në ndonjë rast, në qytete. Për shkak të kësaj dukurie, djem e vajza detyrohen të ngujohen bashkë me pjesëtarët e tjerë të familjes, duke u privuar nga e drejta për të frekuentuar shkollën. Përkundrajt dëshirës së tyre për t’u arsimuar si gjithë moshatarët e tjerë, për të gëzuar e për t’u argëtuar në shkollë e në komunitet, fëmijët e ngujuar vuajnë plagën e tmerrshme të gjakmarrjes, duke mos guxuar të dalin as në rrugicën e lagjes. Duke e vlerësuar ngujimin si një vuajtje shumë të rëndë shpirtërore e morale, në veçanti për fëmijët, nga viti shkollor 2006-2007 e në vijim, ministria përgjegjëse për arsimin ka përmbushur detyrimin ligjor për t’u ofruar fëmijëve të ngujuar shërbim arsimor në kushtet e shtëpisë. Të dhënat statistikore ndër vite kanë ardhur në rënie. **Në**

³ I shfuqizuar. Aktualisht është në fuqi ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

⁴ Ligji nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” (neni 24, pika 5)

vitin shkollor 2015-2016, numri i fëmijëve 6-16 vjeç që ndiqnin arsimin bazë në kushtet e ngujimit, përbënte 0.008 për qind të numrit të përgjithshëm të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor. Aktualisht, në shkallë republike nuk kemi asnjë fëmijë të ngjuar në moshë shkollore.

IV.3. Në cilat faza duhet të kenë kujdes shkollat dhe grupet e interesit për sa i përket mosregjistrimit dhe braktisjes?

Praktikat e deritanishme tregojnë se investimi në arsim sjell dobi në nivele të ndryshme: në aspektin personal, në aspektin familjar në përgjithësi, në aspektin e komunitetit dhe të shoqërisë. Për të konsoliduar me efektivitet nismën “Çdo fëmijë në shkollë”, duhet pasur vëmendje e plotë në tri faza:

- I. Fëmijët që kanë arritur moshën gjashtëvjeçare, duhet të regjistrohen në klasë të parë.
- II. Fëmijët që rikthehen nga ndonjë vend tjetër, ku kanë qenë emigrantë me familjet e tyre, duhet të riintegrohen në shkollë.
- III. Familjet që lëvizin nga një bashki ose vendbanim, të zbatojnë procedurat e domosdoshme të transferimit të nxënësve prej një shkolle në tjetrën.

V. IDENTIFIKIMI I FËMIJËVE JASHTË SHKOLLAVE

V.1. Cili është profili i përbashkët i fëmijëve që nuk janë regjistruar në shkollë?

Në grupin e fëmijëve të paregjistruar ose që nuk e vijnë shkollën, përfshihen:

- Fëmijët e moshës 5-6 vjeç që nuk kanë frekuentuar arsimin parashkollor apo klasën përgatitore.
- Fëmijë të moshës shkollore të cilët nuk janë regjistruar asnjëherë në klasën e parë të arsimit bazë.
- Fëmijët që nuk janë regjistruar kurrë në shkollë për shkak të aftësisë së kufizuar ose ndërrimit të shpeshtë të vendbanimit.
- Fëmijë të rikthyer nga emigracioni dhe që presin për t'u pranuar në shkollë.
- Fëmijë që kanë qenë të trafikuar.
- Fëmijë të dhunuar në mënyrë ekstreme.
- Fëmijë me sëmundje kronike ose lëngime të gjata.
- Fëmijë që punojnë dhe që shfrytëzohen.

FJSA-të mund të mos jenë të evidentuar nga asnjë institucion arsimor, shëndetësor, social etj., ose mund të jenë të evidentuar vetëm në disa regjistra. P.sh., fëmija shfaqet në regjistrin e mjekut familjar, por nuk gjendet në ndonjë regjistr tjetër, si p.sh., në amzën e shkollës apo në regjistrin e klasës.

Shkolla dhe aktorët e përfshirë në nismën “Çdo fëmijë në shkollë” duhet të fokusohen kryesisht në identifikimin e fëmijëve që nuk janë regjistruar asnjëherë në shkollë dhe të ndihmojnë shkollën në trajtimin e rasteve të fëmijëve në rrezik të braktisjes dhe atyre të cilët e kanë braktisur shkollën.

Në vijim do të njihemi me metodat për identifikimin e FJSA-ve, me institucionet dhe mekanizmat që mund të identifikojnë FJSA-të, me treguesit që mund të përdoren për të identifikuar fëmijët në rrezik braktisjeje etj.

Ndërmjetësuesit e komunitetit, të angazhuar në kuadër të projekteve të ndryshme, luajnë rol shumë të rëndësishëm në identifikimin e FJSA-ve. OJF-të, shoqëria civile dhe ndërmjetësuesit në komunitet duhet të raportojnë të gjitha rastet e identifikuara, përmes një formulari-tip, me qëllim trajtimin e çdo rasti për ta integruar çdo fëmijë në shkollë.

V.2. Cili është profili i fëmijëve që janë në rrezik të braktisjes së shkollës?

Fëmijët që janë në rrezik për braktisje të shkollës, janë shpesh:

- Fëmijë me probleme të ndryshme individuale, familjare e sociale.
- Fëmijë me sëmundje kronike ose lëngime të gjata.
- Fëmijë që punojnë ose që janë pengje të dukurive negative (duhanpirje, alkoolizim, narkomani, trafikim, që shfrytëzohen duke i detyruar të kryejnë punë të ndryshme etj.).

V.3. Cili është profili i fëmijëve që kanë braktisur shkollën?⁵

Fëmijët që kanë braktisur shkollën, janë shpesh:


- Fëmijët nga familje me nivel të ulët arsimor.
- Fëmijët e ndikuar nga rreziqet e udhëtimit, nga mungesa e transportit, nga sëmundjet etj.
- Fëmijët e përfshirë në martesë të hershme.

⁵ Nxënësi i arsimit bazë konsiderohet potencialisht braktisës, nëse është regjistruar në fillim të vitit shkollor dhe në fillim të javës së tretë të tetorit raportohet nga shkolla si i paparaqitur. Nxënësi i arsimit bazë konsiderohet braktisës: a) nëse është i regjistruar në shkollë në fillim të vitit shkollor dhe në përfundim të vitit shkollor rezulton i paklasifikuar (mbetës) për shkak të mungesave; b) kur nuk ka mungesa me arsye dhe nuk përmbush asnjë prej kushteve përjashtuese: fatkeqësitë familjare, sëmundje që zgjat shumë ose që shkakton mungesa të rregullta (dokumentuar me raport mjeko-ligjor), transferimi në një shkollë tjetër brenda vendit (i dokumentuar), migrimi jashtë vendit (i dokumentuar), vdekja.

- Fëmijët e ndikuar nga varfëria.
- Fëmijët me probleme në të nxënë.
- Fëmijët - viktimë të dhunës, të trafikimit, të abuzimit seksual dhe të dukurive të tjera negative.

V.4. Cili mund t'i identifikojë fëmijët jashtë shkolle?

Fëmijët jashtë shkolle mund të identifikohen nga institucione, mekanizma dhe profesionistë, si:



V.5. Cilat janë metodat për identifikimin e fëmijëve jashtë shkolle?

Metodat për identifikimin e fëmijëve jashtë shkolle përfshijnë:

- Marrjen e listave nga regjistri i gjendjes civile dhe krahasimi i tyre me listat e fëmijëve të regjistruar në klasën e parë (Këto lista sigurohen nga MB-ja).
- Anketimet e ndryshme në komunitet, të organizuara nga OJF-të, punonjësit e shëndetësisë, shkollat apo bashkitë.
- Identifikimin nga punonjësit e shëndetësisë gjatë vizitave në shtëpi.
- Takimet me komunitetin, të organizuara nga shkollat dhe nga bashkitë.
- Punën në terren nga NJMF-të dhe nga policia në komunitet.
- Fushatat për regjistrimin e fëmijëve gjashtëvjeçarë në klasën e parë.
- Vazhdimësinë e raportimit të rasteve të braktisjes në nivel shkolle, nga drejtorja e shkollës në ZVA dhe nga ZVA-ja në MASR (DRAP/DPAP).
- Mbikëqyrjen e transferimeve të nxënësve nga shkolla në shkollë, brenda e jashtë bashkisë.

- Mbledhjen e informacioneve nga bashkëmoshatarët dhe të afërmit e FJSA-ve, të cilët frekuentojnë rregullisht mësimet në shkollë.
- Kryqëzimin e të dhënave për fëmijët nga disa burime: të dhënat nga sistemi shëndetësor; të dhënat e të rikthyerve nga emigracioni; të dhënat nga skema e përkrahjes sociale.

Nëse një institucion apo grup interesi identifikon FJSA-të nga burimet e sipërpërmendura, ai e njofton shkollën në zonën përkatëse të mbulimit, me qëllim sistemimin e çdo FJSA-je në shkollë.

V.6. Pse është e rëndësishme analiza e gjendjes dhe si bëhet ajo?

Analiza e gjendjes na jep një tablo të qartë të situatës dhe pasuron të dhënat fillestare që kemi për FJSA-të dhe për fëmijët që rrezikojnë të braktisin shkollën. Analiza e gjendjes kryhet përmes grumbullimit të të dhënave nga të gjitha institucionet dhe mekanizmat përgjegjës.

Së pari, çdo shkollë kërkon dhe siguron të dhëna nga SMIA, duke u bazuar në treguesit specifikë për: (i) numrin e përgjithshëm të fëmijëve të regjistruar dhe atyre që kanë braktisur shkollimin në vitin shkollor paraardhës; (ii) numrin e fëmijëve, familjet e të cilëve janë në asistencë sociale; (iii) gjendjen familjare të nxënësit (me dy prindër, me njërin prind apo pa asnjë prind); (iv) nxënësit e rikthyer nga emigracioni; (v) largësinë e shkollës nga shtëpia e secilit nxënës; (vi) dëmtimet e ndryshme; (vii) gjininë; (viii) fëmijët përsëritës klase; (ix) fëmijët me AK, (x) fëmijët romë, egjiptianë; (xi) moshën e tyre.

Pas grumbullimit të të dhënave nga SMIA, shkollës i vijnë të dhëna nga ZVA-ja. Këto të dhëna janë listat e dërguara nga MASR-ja (DPAP/QShA), pas krahasimit të bërë me listat që MASR-së i vijnë nga MB-ja dhe nga MShMS-ja. Shkolla i krahason të dhënat e ardhura me të dhënat e marra nga SMIA, si p.sh., numri i fëmijëve nga SMIA krahasuar me numrin e fëmijëve të regjistruar në regjistrin e gjendjes civile në bazë të viteve të lindjes, për të nxjerrë analiza dhe të dhëna që ndihmojnë në identifikimin e fëmijëve jashtë shkollës.

Gjithashtu, shkolla bazohet dhe në informacione të tjera nga burime të ndryshme, si: ndërmjetësuesit në komunitet, anketat e ndryshme nga OJF-të, mekanizmat e tjerë jozyrtarë etj.

Të gjitha të dhënat e mbledhura, shkolla i analizon për të identifikuar problemet, pengesat dhe përparësitë për realizimin e vijueshmërisë së rregullt të shkollës nga të gjithë nxënësit. Bazuar në këto analiza, ajo harton planin e veprimit dhe zhvillon veprimtari konkrete për të trajtuar me efikasitet problematikën në fjalë.

V.7. Çfarë treguesish duhet të përdoren për të identifikuar fëmijët në rrezik braktisjeje të shkollës?

Ekzistojnë disa tregues që ndihmojnë në identifikimin e fëmijëve që rrezikojnë të braktisin shkollën. Treguesit më të zakonshëm janë: vijimi jo i rregullt i mësimet, rezultatet e ulëta në të nxënë, sjellja jo e mirë në shkollë, kushtet e vështira familjare ose rrethanat e vështira personale të fëmijës, presioni i moshatarëve etj.

Sigurisht, është më mirë të parandalosh braktisjen, sesa të trajtosh **problemin** pasi fëmijët e kanë braktisur shkollën.

Treguesit e rekomanduar për shkollën jepen në tabelën që vijon:

Treguesit e propozuar	Përshkrimi i treguesve
Vijimi	Nxënësi ka munguar në më shumë se 20 orë në muaj pa ndonjë arsye të vlefshme
Rezultatet e ulëta në të nxënë	Nxënësi nuk mund të lexojë, nuk di të shkruajë ose të numërojë si duhet për moshën e tij, ose nxënësi ka nota të ulëta në lëndët kryesore
Sjellja	Nxënësi silllet vazhdimisht keq, ose është vazhdimisht shumë agresiv në shkollë
Mosha	Nxënësi është dy vjet ose më shumë mbi moshë nga shokët/shoqet e klasës

Shëndeti	Nxënësi është me aftësi të kufizuara, vuan nga sëmundje kronike ose sëmundje të tjera serioze fizike / psikologjike (duke përfshirë traumat e kaluara) etj.
Rrethanat familjare	Nxënësi përballlet me rrethana të ndërlikuara familjare, siç janë: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Nxënësi është bonjak⁶ ose nuk jeton me prindër; ▪ Prindërit e nxënësit janë me aftësi të kufizuara; ▪ Familja e nxënësit përballlet me varfërinë e skajshme ose me ndonjë rrethanë tjetër ekstreme; ▪ Martesat e hershme të fëmijës; ▪ Nxënësi është prind; ▪ Nxënësi punon.
Angazhimet familjare	Familja e nxënësit nuk e vlerëson shkollimin; refuzon të angazhohet në shkollë ose angazhohet shumë pak në shkollë
Presioni i moshatarëve	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Vëllezërit / motrat / kushërinjtë / prindërit e nxënësit e kanë braktisur shkollën ose e kanë vijuar mësimin në mënyrë të çrregullt. ▪ Rrjeti kryesor i moshatarëve të nxënësit përfshin fëmijë ose të rinj jashtë shkolle (fëmijë braktisës, të rinj më në moshë) ose njerëz me sjellje të njohur antishoqërore.
Siguria	Nxënësi është viktimë ose në rrezik të: <ul style="list-style-type: none"> ▪ Dhunës familjare; ▪ Formave të tjera të abuzimit, braktisjes ose shfrytëzimit.

Situata është e ndryshme nga njëra shkollë në tjetrën, nga njëra bashki në tjetrën. Për këtë arsye, treguesit mund të përshtaten në varësi të rrethanave dhe specifikave të shkollës dhe të hapësirës gjeografike që mbulon shkolla. Për shembull, nëse disa fëmijë e kanë braktisur shkollën gjatë viteve të mëparshme, për shkak të mjeteve të pamjaftueshme të transportit për në shkollë, atëherë “Transporti” mund të shtohet si tregues në listën e propozuar të treguesve, sikurse mund të shtohet si tregues **“Tualeti”**, kur mungesa e nyjeve sanitare bëhet shkak që nxënësit, sidomos vajzat, të mos e frekuentojnë shkollën.

⁶ Jetim

VI. AKTORËT, ROLI I TYRE, DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

VI.1. Ministritë e përfshira në M3M dhe në U3M

Ministritë nënshkruese të M3M dhe të U3M janë iniciuesit e nismës “Çdo fëmijë në shkollë” dhe aktorët kryesorë për zbatimin e kësaj nisme. Tri ministritë kanë detyrim reciprok të shkëmbejnë informacione në format shkresor dhe/ose elektronik për problemet që lindin gjatë zbatimit të Marrëveshjes dhe të Rregullores.

Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë drejton Komisionin Ndërmintor (KN) të ndjekjes së arsimit nga të gjithë nxënësit, që përbëhet nga zëvendësministrat e MASR-së, MB-së dhe MShMS-së dhe shqyrton zbatimin e Marrëveshjes në mes ministrive dhe të Rregullores përkatëse. Në mbledhjen e Komisionit Ndërmintor marrin pjesën edhe të ftuar të propozuar nga ministritë.

VI.2 Roli dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të Qendrës së Shërbimeve Arsimore

Roli 1:

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë (MASR), brenda datës 1 mars të çdo viti, u dërgon, në format elektronik, datën e fillimit të vitit të ardhshëm shkollor Ministrisë së Brendshme (MB) dhe zyrave vendore arsimore.

Veprimtaritë:

- MASR-ja nxjerr urdhrin për strukturën e vitit të ardhshëm shkollor brenda datës 20 shkurt të çdo viti.
- MASR-ja publikon urdhrin për strukturën e vitit të ardhshëm shkollor në faqen elektronike zyrtare dhe e dërgon, në format elektronik, në MB dhe në çdo ZVA brenda datës 1 mars.
- MASR-ja pret nga MB-ja, brenda datës 10 prill, në format elektronik, listën e fëmijëve që duhet të fillojnë klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor, me të gjithë përbërësit e parashikuar⁷ (neni 2 i U3M).

Roli 2:

QShA-ja, brenda datës 10 maj: të hartojë listën e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor, bazuar në listat e parashikuara në nenet 5 dhe 8 të U3M; të përpilojë listat e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor për çdo zyrë vendore arsimore; t’u dërgojë zyrave vendore arsimore listat përkatëse me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare.

Veprimtaritë:

- QShA-ja harton listën e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor, bazuar në listat e parashikuara në nenet 5 dhe 8 të U3M, brenda datës 20 prill.
- QShA-ja përpilon listat e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor për çdo njësi arsimore vendore, brenda datës 30 prill.
- QShA-ja u dërgon zyrave vendore arsimore listat përkatëse me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare, brenda datës 10 maj.

Roli 3:

QShA-ja, brenda muajit tetor të çdo viti, të përmbledhë listat e parashikuara në nenet 21 dhe 22 të U3M dhe t’i dërgojë te zyrat vendore arsimore përkatëse të dhënat për fëmijët ende të paidentifikuar si dhe ata që janë transferuar.

⁷ Lista fëmijëve, që duhet të ndjekin klasën e parë, përmban këta përbërës: Emri, mbiemri, emri i babait, emri i nënës, numri personal, gjinia, datëlindja, vendlindja dhe vendbanimi.

Veprimtaritë:

- a) QShA-ja përmbledh listat e ardhura nga ZVA-të në formë elektronike dhe shkresore, me të dhënat e fëmijëve që nuk janë identifikuar nga përgjegjësit e njësive administrative dhe nga punonjësit e policisë së zonës ose që rezultojnë të transferuar, brenda datës 20 tetor.
- b) QShA-ja përpilon listën e fëmijëve që nuk janë identifikuar nga përgjegjësit e njësive administrative dhe nga punonjësit e policisë së zonës ose që rezultojnë të transferuar, brenda datës 20 tetor.
- c) QShA-ja u dërgon ZVA-ve listat përkatëse, me postë elektronike dhe me shkresë zyrtare, brenda datës 22 tetor.
- ç) QShA-ja merr raportime nga ZVA-të për identifikimin e fëmijëve të përfshirë në listat e përcaktuara në U3M dhe për regjistrimin e tërheqjen e tyre në shkollë (publike apo private).

VI.3. Roli dhe përgjegjësitë e zyrave vendore arsimore dhe e shkollave publike e private**Roli 1:**

Çdo zyrë vendore arsimore, brenda datës 5 mars, të dërgojë, me shkresë zyrtare, te qendrat përkatëse shëndetësore datën e fillimit të vitit të ardhshëm shkollor.

Veprimtaritë:

- a) ZVA-ja, me shkresë zyrtare, njofton të gjitha QSh-të brenda juridiksionit për datën e fillimit të vitit të ardhshëm shkollor.
- b) ZVA-ja u kërkon shkollave fillimin e punës për identifikimin e fëmijëve gjashtëvjeçarë që do të regjistrohen në klasën e parë.
- c) ZVA-ja harton planin e veprimit për zbatimin e M3M dhe të U3M për vitin e ardhshëm shkollor, brenda datës 15 mars.

Roli 2:

Çdo QShA-ja, brenda datës 10 prill, me qëllim evidentimin e familjeve të fëmijëve që janë në rrezik të mos ndjekin klasën e parë: të bashkëpunojë me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve; të bashkëpunojë me shkollat që kanë pasur probleme në ndjekjen e klasës së parë; të organizojë takime me OJF-të që kanë zhvilluar projekte për ndjekjen e arsimit bazë.

Veprimtaritë:

- a) ZVA-ja bashkëpunon me NjMF-në për identifikimin e fëmijëve me probleme në familje apo të dhunuar nga familja që rrezikojnë të mos e ndjekin klasën e parë.
- b) ZVA-ja bashkëpunon me shkollat që kanë pasur probleme në ndjekjen e klasës së parë nga fëmijët gjashtëvjeçarë apo dhe më të rritur.
- c) ZVA-ja organizon takime me OJF-të që kanë zhvilluar projekte për ndjekjen e arsimit bazë, me qëllim identifikimin e problematikave dhe të familjeve të fëmijëve që rrezikojnë të mos e ndjekin klasën e parë apo të braktisin shkollën pa përfunduar klasën e nëntë.

Roli 3:

Zyra vendore arsimore, brenda muajit maj, t'u dërgojë në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, të gjitha shkollave publike dhe atyre private në juridiksionin e saj, listën e fëmijëve që do të ndjekin klasën e parë, të plotësuar me të dhënat e parashikuara.

Veprimtaritë:

- a) ZVA-ja u dërgon, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, të gjitha shkollave publike dhe atyre private në juridiksionin e saj, listën e fëmijëve që do të ndjekin klasën e parë, të plotësuar me të dhënat e parashikuara.
- b) ZVA-ja monitoron shkollat që kanë pasur probleme në ndjekjen e klasës së parë nga fëmijët gjashtëvjeçarë apo dhe më të rritur.

- c) ZVA-ja organizon takime të përbashkëta të shkollave me OJF-të që kanë zhvilluar projekte për ndjekjen e arsimit bazë, me qëllim identifikimin e fëmijëve që janë në listat e klasës së parë.

Roli 4:

Drejtorët e shkollave publike dhe ato private, brenda 3 ditëve pune pas datës së fillimit të vitit shkollor, t'u dërgojnë ZVA-ve përkatëse, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, listën emërore të fëmijëve që janë të regjistruar në klasën e parë, duke pasur parasysh përbërësit e parashikuar.

Veprimtaritë:

- a) Çdo drejtor shkolle, publike dhe private, harton listën emërore të fëmijëve që janë të regjistruar në klasën e parë, të plotësuar me të gjitha të dhënat e parashikuara.
- b) Çdo drejtor shkolle, publike dhe private, i dërgon ZVA-së, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, listën emërore të fëmijëve që janë të regjistruar në klasën e parë, të plotësuar me të dhënat e parashikuara.

Roli 5:

Çdo ZVA, bazuar në raportimet e shkollave, brenda 5 ditëve pune nga njoftimet e shkollave, të hartojë në format elektronik këto dokumente:

- Listën e fëmijëve të peregjistruar në klasën e parë, sipas zonës që i takon çdo shkolle të arsimit bazë në juridiksion.
- Listën e fëmijëve të peregjistruar në klasën e parë, sipas zonave që mbulojnë nënndarjet administrative përkatëse (neni 13/b i U3M).
- Listën e fëmijëve të peregjistruar në klasën e parë, sipas zonave që mbulojnë komisariatet përkatëse të policisë (neni 13/c i U3M).

Veprimtaritë:

- a) ZVA-ja përpunon dhe përmbledh listat e raportuara nga shkollat.
- b) ZVA-ja harton në format elektronik:
- Listën e fëmijëve të peregjistruar në klasën e parë, sipas zonës që i takon çdo shkolle të arsimit bazë në juridiksion.
 - Listën e fëmijëve të peregjistruar në klasën e parë, sipas zonave që mbulojnë nënndarjet administrative përkatëse (neni 13/b i U3M).
 - Listën e fëmijëve të peregjistruar në klasën e parë, sipas zonave që mbulojnë komisariatet përkatëse të policisë (neni 13/c i U3M).

Roli 6:

Çdo ZVA t'u dërgojë menjëherë, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, kryetarit të bashkisë përkatëse dhe shefit të Komisarariatit përkatës të Policisë dhe, për dijeni, Prefektit përkatës, listën e fëmijëve që ende nuk janë regjistruar në klasën e parë, të parashikuara në shtojcën me të dhënat për çdo fëmijë.

Veprimtaritë:

- a) ZVA-ja harton listën e fëmijëve që ende nuk janë regjistruar në klasën e parë, të parashikuara në shtojcën me të dhënat për çdo fëmijë.
- b) ZVA-ja i dërgon kryetarit të bashkisë, brenda datës 30 shtator, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, listën e fëmijëve që ende nuk janë regjistruar në klasën e parë, të parashikuara në shtojcën me të dhënat për çdo fëmijë.
- c) ZVA-ja i dërgon shefit të komisarariatit të Policisë, brenda datës 30 shtator, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, listën e fëmijëve që ende nuk janë regjistruar në klasën e parë, të parashikuara në shtojcën me të dhënat për çdo fëmijë.
- ç) ZVA-ja i dërgon Prefektit, për dijeni, brenda datës 30 shtator, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, listën e fëmijëve që ende nuk janë regjistruar në klasën e parë, të parashikuara në shtojcën me të dhënat për çdo fëmijë.

Roli 7:

Çdo ZVA, brenda datës 15 tetor, t'u dërgojë, në format elektronik ose/edhe me shkresë zyrtare, shkollave publike dhe atyre private, që kanë raportuar fëmijë të peregjistruar, listën e fëmijëve me të dhënat e plotësuara nga përgjegjësi i nënndarjes administrative dhe nga punonjësi i policisë së zonës dhe që i takojnë shkollës.

Veprimtaritë:

- a) ZVA-ja harton, për çdo shkollë, listën e fëmijëve të peregjistruar, me të dhënat e plotësuara nga përgjegjësi i njësisë administrative dhe nga punonjësi i policisë së zonës dhe që i takojnë shkollës.
- b) ZVA-ja i dërgon çdo shkollë publike dhe private, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, listën e fëmijëve të peregjistruar, me të dhënat e plotësuara nga përgjegjësi i njësisë administrative dhe nga punonjësi i policisë së zonës dhe që i takojnë shkollës.
- c) ZVA-ja monitoron çdo shkollë publike dhe private për masat e marra për tërheqjen dhe regjistrimin në shkollë të çdo fëmije të peregjistruar, të identifikuar nga përgjegjësi i nënndarjes administrative dhe nga punonjësi i policisë së zonës dhe që i takon shkollës.

Roli 8:

Shkollat publike, brenda muajit tetor, të regjistrojnë nxënësit e peregjistruar, që i përkasin zonës së tyre, bazuar në shkresën zyrtare të dërguar nga ZVA-ja.

Veprimtaritë:

- a) Çdo shkollë publike, bazuar në shkresën zyrtare të dërguar nga ZVA-ja, identifikon nxënësit e peregjistruar, që i përkasin zonës së saj.
- b) Çdo shkollë publike, pasi identifikon të gjithë nxënësit e peregjistruar, që i përkasin zonës së saj, merr masa për mirëpritjen e tyre, duke caktuar klasën dhe mësuesin, si dhe duke porositur tekstet shkollore për çdo nxënës që do të presë.
- c) Çdo shkollë publike, bazuar në shkresën zyrtare të dërguar nga ZVA-ja, regjistron në shkollë nxënësit e peregjistruar, që i përkasin zonës së saj.
- ç) ZVA-ja monitoron çdo shkollë publike për masat e marra për krijimin e mjedisit mirëpritës për çdo nxënës që do të regjistrohet me vonesë.
- d) Çdo shkollë publike njofton me shkresë zyrtare ZVA-në për regjistrimin në shkollë të çdo nxënësi të peregjistruar, që i përket zonës së saj, dhe për planin e veprimit për mbajtjen në shkollë të nxënësve të regjistruar me vonesë.

Roli 9:

Çdo ZVA, brenda datës 20 tetor, të hartojë listën e fëmijëve që nuk janë identifikuar nga përgjegjësit e njësive administrative ose nga punonjësit e policisë së zonave apo që rezultojnë të transferuar, dhe ta dërgojë në QShA.

Veprimtaritë:

- a) ZVA-ja harton listën e fëmijëve të paidentifikuar nga përgjegjësit e njësive administrative dhe nga punonjësit e policisë së zonave, dhe të fëmijëve që rezultojnë të transferuar për arsye ndryshimi të vendbanimit etj.
- b) ZVA-ja i dërgon QShA-së listën e fëmijëve të paidentifikuar nga përgjegjësit e njësive administrative dhe nga punonjësit e policisë së zonave, dhe të fëmijëve që rezultojnë të transferuar për arsye ndryshimi të vendbanimit etj.
- c) ZVA-ja pret nga QShA-ja listën e fëmijëve të paidentifikuar nga përgjegjësit e njësive administrative dhe nga punonjësit e policisë së zonave, dhe të fëmijëve që rezultojnë të transferuar për arsye ndryshimi të vendbanimit etj.

Roli 10:

Çdo ZVA të njoftojë menjëherë shkollat publike përkatëse bazuar në listën e parashikuar në pikën 3 të nenit 21 të U3M.

Veprimtaritë:

- a) ZVA-ja përpunon listën e ardhur nga QShA-ja, duke hartuar listën përkatëse për çdo shkollë, e cila përmban fëmijët e paidentifikuar dhe që rezultojnë të transferuar për arsye ndryshimi të vendbanimit etj.
- b) ZVA-ja u dërgon shkollave listën e ardhur nga QShA-ja me fëmijët e paidentifikuar dhe ata që rezultojnë të transferuar.

Roli 11:

Mësuesit e shkollave publike përkatëse të merren me regjistrimin e fëmijëve të parashikuar në pikën 3 të nenit 21 të U3M.

Veprimtaritë:

- a) Drejtori i shkollës publike cakton mësuesit që do të merren me pritjen dhe regjistrimin e fëmijëve të paidentifikuar ose të transferuar.
- b) Shkolla, drejtorja dhe mësuesit, bashkëpunojnë me përgjegjësën e njësisë administrative dhe me punonjësën e policisë së zonës për identifikimin e fëmijëve të paidentifikuar ose të transferuar.
- c) Shkolla regjistron fëmijët e paidentifikuar dhe ata që rezultojnë të transferuar.

Roli 12:

1. Drejtori i shkollës publike të njoftojë ZVA-në përkatëse për efektivitetin e përpjekjeve për regjistrimin e fëmijëve të parashikuar në pikën 4 21 të U3M.

Veprimtaritë:

- a) Drejtori i shkollës, në përfundim të procesit për identifikimin dhe regjistrimin e fëmijëve të paidentifikuar deri atëherë apo të transferuar, njofton me shkresë zyrtare ZVA-në për tërheqjen ose jo të këtyre kategorive të fëmijëve.
- b) Drejtorja e shkollës dhe mësuesit, në rast mosefektiviteti të përpjekjeve për të tërhequr dhe regjistruar fëmijët e identifikuar me vonesë apo të transferuar, vazhdon bashkëpunimin me bashkinë, Komisarjatin e Policisë, me OJF-të etj. për të marrë në shkollë çdo fëmijë në moshë shkollore.

VI.4. Roli dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe e qendrave shëndetësore

Roli 1:

Qendrat shëndetësore, brenda datës 2 prill të çdo viti, të dërgojnë në format elektronik ose me shkresë zyrtare, listën e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë përkatësisht te Drejtorja përkatëse Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor. Fëmijët, që kanë detyrimin të regjistrohen në klasën e parë, janë ata që mbushin moshën 6 vjeç deri një ditë para fillimit të vitit shkollor.

Veprimtaritë:

- a) QSh-të hartojnë, në format elektronik ose me shkresë zyrtare, listën e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë.
- b) QSh-të dërgojnë, në format elektronik ose me shkresë zyrtare, listën e fëmijëve që duhet të ndjekin klasën e parë te Drejtorja Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor.

Roli 2:

Drejtorja Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, brenda datës 10 prill të çdo viti, të hartojnë në format elektronik listën përmbledhëse

të të dhënave të paraqitura nga qendrat shëndetësore dhe t'ia dërgojnë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MShMS).

Veprimtaritë:

- a) Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, brenda datës 5 prill të viti, harton në format elektronik listën përmbledhëse të të dhënave të paraqitura nga QSh-të.
- b) Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor/Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, brenda datës 10 prill të çdo viti, i dërgon Ministrisë së Shëndetësisë (MSh) në format elektronik listën përmbledhëse të të dhënave të paraqitura nga QSh-të.

Roli 3:

MShMSh-ja të dërgojë në MASR, brenda datës 15 prill të çdo viti, në format elektronik, listat e parashikuara në nenin 6 të U3M.

Veprimtaritë:

- a) MShMS-ja harton në format elektronik listën përmbledhëse të të dhënave të paraqitura nga QSh-të në shkallë vendi.
- b) MShMS-ja i dërgon MASR-së në format elektronik listën përmbledhëse të të dhënave të paraqitura nga QSh-të në shkallë vendi.

VI.5. Roli dhe përgjegjësitë e Ministrisë së Brendshme

Roli 1:

MB-ja, brenda datës 10 prill të çdo viti, të dërgojë në MASR, në format elektronik, listën e fëmijëve që duhet të fillojnë klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor sipas përbërësve të parashikuar në nenin 2 të U3M.

Veprimtaritë:

- a) MB-ja harton në format elektronik listën e fëmijëve që duhet të fillojnë klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor sipas përbërësve të parashikuar, në shkallë vendi.
- b) MB-ja i dërgon MASR-së në format elektronik listën përmbledhëse të fëmijëve që duhet të fillojnë klasën e parë në vitin e ardhshëm shkollor sipas përbërësve të parashikuar, në shkallë vendi.

VI.6. Roli dhe përgjegjësitë e bashkive

Roli 1:

Kryetari i bashkisë, brenda 4 ditëve pune nga marrja në dijeni e shkresës zyrtare të dërguar nga ZVA-ja, të parashikuar në nenin 15 të U3M, duke pasur parasysh adresat e fëmijëve, të përcjellë për plotësim shtojcën te personi përgjegjës i nënndarjes administrative.

Veprimtaritë:

- a) Kryetari i bashkisë, duke pasur parasysh adresat e fëmijëve, harton shtojcën me adresat e fëmijëve për t'ia përcjellë personit përgjegjës të njësisë administrative.
- b) Kryetari i bashkisë, duke pasur parasysh adresat e fëmijëve, i përcjell për plotësim shtojcën personit përgjegjës të njësisë administrative.

Roli 2:

Personi përgjegjës i njësisë administrative, brenda 6 ditëve pune nga marrja në dijeni e kërkesës nga kryetari i bashkisë, të kryejë verifikimet në terren, të plotësojë shtojcën për çdo fëmijë dhe ta dërgojë te kryetari përkatës i njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore.

Veprimtaritë:

- a) Personi përgjegjës i njësisë administrative, duke pasur parasysht adresat e fëmijëve, kryen verifikimet në terren.
- b) Personi përgjegjës i njësisë administrative plotëson shtojcën për çdo fëmijë.
- c) Personi përgjegjës i njësisë administrative dërgon te kryetari i bashkisë shtojcën e plotësuar për çdo fëmijë.

Roli 3:

Kryetari i bashkisë të përcjellë menjëherë shtojcën e plotësuar te ZVA-ja, nga e cila ka ardhur kërkesa, si dhe të informojë Prefektin me shkresë zyrtare për ecurinë e procesit.

Veprimtaritë:

- a) Kryetari i bashkisë merr shtojcat e ardhura nga personat përgjegjës të njësive administrative dhe harton shtojcën përmbledhëse në nivel bashkie.
- b) Kryetari i bashkisë përcjell në ZVA shtojcën përmbledhëse në nivel bashkie.
- c) Kryetari i bashkisë informon Prefektin me shkresë zyrtare për ecurinë e procesit.

VI.7. Roli dhe përgjegjësitë e komisariateve të policisë

Roli 1:

Shefi i Komisarariatit të Policisë, brenda 4 ditëve pune nga marrja në dijeni e shkresës zyrtare të dërguar nga ZVA-ja, të parashikuar në nenin 13/b të U3M, duke pasur parasysht adresën e fëmijës, të përcjellë për plotësim shtojcën e parashikuar në pikën c të nenit 13 të U3M te punonjësi i policisë së zonës.

Veprimtaritë:

- a) Shefi i Komisarariatit të Policisë, pas marrjes së shkresës zyrtare nga ZVA-ja, duke pasur parasysht adresën e fëmijës, përgatit shtojcën e parashikuar në pikën 13 të U3M për çdo punonjës policie në zonat që mbulon.
- b) Shefi i Komisarariatit të Policisë, pas marrjes së shkresës zyrtare nga ZVA-ja, duke pasur parasysht adresën e fëmijës, i dërgon për plotësim shtojcën e parashikuar në pikën c të nenit 13 të U3M çdo punonjës policie në zonat që mbulon.

Roli 2:

Punonjësi i policisë së zonës, brenda 6 ditëve pune nga marrja në dijeni e kërkesës nga shefi përkatës i Komisarariatit të Policisë, të kryejë verifikimet në terren, të plotësojë shtojcën për çdo fëmijë dhe ta dërgojë te shefi i Komisarariatit të Policisë.

Veprimtaritë:

- a) Punonjësi i policisë së zonës, pas marrjes së shtojcës, duke pasur parasysht adresën e fëmijës, bën verifikimet e nevojshme në terren në zonën që mbulon.
- b) Punonjësi i policisë së zonës, pas verifikimeve që bën në terren, duke pasur parasysht adresën e fëmijës, plotëson shtojcën për çdo fëmijë.
- c) Punonjësi i policisë së zonës, pasi plotëson shtojcën për çdo fëmijë, e dërgon atë te shefi i Komisarariatit të Policisë.

Roli 3:

Shefi i Komisarariatit të Policisë të përcjellë menjëherë shtojcën e plotësuar te ZVA-ja, nga e cila ka ardhur kërkesa, si dhe të informojë Prefektin me shkresë zyrtare për ecurinë e procesit.

Veprimtaritë:

- a) Shefi i Komisarariatit të Policisë, pas marrjes së shtojcës nga PPZ, ia përcjell menjëherë shtojcën ZVA-së.
- b) Shefi i Komisarariatit të Policisë informon Prefektin me shkresë zyrtare për ecurinë e procesit.

VI.8. Roli i Prefektit

Për çdo mosrespektim të ndonjë afati, organi pritës të njoftojë menjëherë me shkresë zyrtare organin dërgues dhe Prefektin.

Roli 1:

Prefekti të organizojë monitorimin e procesit dhe, në rast konstatimi të rasteve të mosplotësimit të detyrave, të marrë masat e nevojshme për zbatimin e kësaj Rregulloreje nga institucionet përgjegjëse.

Veprimtaritë:

- a) Prefekti organizon monitorimin e procesit për të konstatuar raste të mundshme të mosplotësimit të detyrave.
- b) Prefekti, për çdo konstatim të mosrespektimit të afateve dhe të mosplotësimit të detyrave, merr masat e nevojshme për zbatimin e detyrimeve.

VII. ANALIZA E GJENDJES DHE HAPAT PËR PËRMIRËSIM

Për një analizë serioze të problemeve që lidhen drejtpërdrejt me braktisjen shkollore dhe me arritjen e synimit për të pasur në shkollë çdo fëmijë në moshën shkollore të detyruar, duhen marrë parasysh këta hapa:

VII.1. Hapi I: Ku jemi tani?

Disa nga drejtimet e punës janë:

1. Grumbullimi i të dhënave për braktisjen e shkollës dhe për fëmijët e peregjistruar në shkollë.
 - Numri i nxënësve në moshën shkollore të detyruar që nuk janë regjistruar në shkollë, në zonën që mbulon shkolla dhe tendenca përgjatë viteve:
 - Numri i nxënësve që e kanë braktisur shkollën dhe tendenca përgjatë viteve.
 - Numri i nxënësve në rrezik të braktisjes së shkollës dhe tendenca përgjatë viteve.
 - Shkalla e vijimit në shkollë, në secilën orë mësimore, në të gjitha lëndët e planit mësimor.
2. Analiza e të dhënave për braktisjen e shkollës, për fëmijët e peregjistruar dhe për fëmijët që nuk vijnë rregullisht mësimet:
 - Cilët janë fëmijët e peregjistruar, të cilët po e braktisin shkollën, dhe cilët janë nxënësit në rrezik të braktisjes së shkollës?
 - Këta fëmijë/nxënës janë djem apo vajza? Çfarë moshe janë? Në cilën klasë janë regjistruar?
 - Pse nuk vijnë në shkollë këta fëmijë/nxënës?
 - Cilat janë arsyet kryesore të mosvijueshmërisë në shkollë?
 - Cilat janë arsyet që kanë të bëjnë me vetë fëmijët (faktorët individualë)?
 - Cilat janë arsyet që kanë të bëjnë me familjet e fëmijëve (faktorët familjarë)?
 - Cilat janë arsyet që lidhen me vetë shkollën (praktikat shkollore dhe politikat e pamjaftueshme mbështetëse dhe gjithëpërfshirëse)?
3. Vlerësimi i praktikave shkollore për parandalimin e braktisjes së shkollës dhe për reagim të menjëhershëm ndaj çdo rasti të braktisjes së shkollës:
 - Sa efektive janë politikat dhe praktikat e të gjitha institucioneve arsimore parauniversitare për regjistrimin e fëmijëve gjashtëvjeçarë në klasën e parë?
 - Sa efektive është puna në terren për identifikimin e fëmijëve të peregjistruar në shkollë?
 - Sa efektiv është sistemi i menaxhimit të mosvijueshmërisë së nxënësve në shkollë?
 - Sa efektiv ka qenë zbatimi i strategjive për parandalimin e braktisjes së shkollës në të kaluarën?
 - Çfarë ka funksionuar dhe si e pse? Çfarë nuk ka funksionuar dhe pse?
 - Sa efektive është shkolla në (ri)integrimin e fëmijëve në shkollë?
 - Sa i mbështet shkolla fëmijët e (ri)integruar në shkollë? Po fëmijët në rrezik të braktisjes së shkollës?
 - Sa efektive janë veprimtaritë për mbështetjen e nxënies së mësimin të organizuara për fëmijët e prapambetur (orë të gjuhës, orë plotësuese, plani i edukimit individual etj.)?
 - Sa gjithëpërfshirëse është shkolla? Sa përgjigjet efektivisht ajo ndaj shumëllojshmërisë së nxënësve (përkatësisë etnike, prejardhjes shoqërore e kulturore, paaftësive dhe nevojave për arsim special etj.)?
 - Sa i vetëdijshëm është stafi i shkollës (mësuesit, drejtuesit, mësuesit ndihmës, psikologu / punonjësi social) për çështjet e mosregjistrimit dhe të braktisjes së shkollës?
 - Sa efektive është shkolla në komunikimin dhe ngritjen e vetëdijes dhe të bashkëpunimit me prindërit për çështjen e mosregjistrimit dhe të braktisjes së shkollës?
 - Sa efektivë janë komunikimi i shkollës me aktorët e tjerë të përfshirë në këto çështje dhe bashkërendimi i punës me: Organizatat e shoqërisë civile, ZVA-të, përgjegjësit e njësive administrative, punonjësit e policisë së zonës, policinë në komunitet, shkollat e tjera (përfshirë dhe kopshtet e arsimit parashkollor) dhe me çdo grup tjetër të interesuar?
 - A janë përparësi e shkollës parandalimi dhe reagimi ndaj braktisjes?

VII.2. Hapi II: Ku duam të jemi?

1. Diskutim i vizionit të shkollës: Çfarë do të arrijë shkolla sa i përket parandalimit të braktisjes dhe reagimit ndaj braktisjes së shkollës?
2. A është real dhe ambicioz synimi i shkollës për parandalimin dhe reagimin ndaj braktisjes shkollore?

VII.3. Hapi III: Si do të arrijmë atje?

Cilat veprimtari mund të zbatojë realisht shkolla për të arritur synimin e saj? Ndoshta do t'i duhet të mendojë për:

- Veprimtaritë për ngritjen e vetëdijes së komunitetit (për regjistrimin në klasën e parë për komunitetet specifike etj.).
- Veprimtaritë për zvogëlimin e mungesave nga nxënësit në shkollë.
- Veprimtaritë për mbështetjen e nxënësve të prapambetur në mësim dhe me vështirësi në të nxënë.
- Themelimin dhe funksionimin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm për identifikimin e fëmijëve në rrezik të braktisjes së shkollës.
- Të punuarit ngushtësisht me organizatat e shoqërisë civile, me OJF-të etj.
- Veprimtaritë për rritjen e pjesëmarrjes së nxënësve në shkollë dhe për gjithëpërfshirjen.
- Veprimtaritë për frymëzimin e nxënësve dhe krijimin e ndjenjës së identifikimit me shkollën.
- Veprimtaritë për përmirësimin e klimës shkollore (disiplina, respektimi i diversitetit të grupeve, mosdiskriminimi, gjithëpërfshirja etj.).

P.sh., është e rëndësishme që shkolla të organizojë një ose disa takime me nxënësit e rinj, në javët e para të mbërritjes së tyre. Qëllimi është për të treguar se shkolla punon si një ekip dhe se të rriturit dhe stafi kujdesen për të gjithë nxënësit, edhe për të sapoardhurit. Kjo shërben, gjithashtu, për të treguar interesim në veprimtaritë e shkollës dhe për të krijuar ndjenjën e përkatësisë. Ka shumë për të mësuar për nxënësit e rinj, prandaj veprimtaritë hyrëse mund të përsëriten sipas nevojës, gjatë muajve të parë të vitit shkollor. Gjithashtu, nxënësit, të cilët kanë munguar gjatë veprimtarive hyrëse masive, duhet të lejohen t'i bashkohen grupit tjetër për të përfituar prej tyre. Për më tepër, për të ngritur integritimin e klasës së re, shkolla mund të organizojë veprimtari për krijimin e ekipit, që në fillim të vitit shkollor. Kjo mund të bëhet përmes ekskursioneve dhe ditëve jashtë shkollës / shëtitjeve në fillim të vitit shkollor, punës në grup dhe ngjarjeve të ndryshme shkollore. Kanë vlera të veçanta sistemet e vendosjes në çift të nxënësve të vegjël dhe nxënësit më të rritur, në mënyrë që të mbështeten nxënësit e rinj në muajt e parë përmes një klime miqësore. Ky sistem mund të kontribuojë, gjithashtu, në parandalimin e dhunës ndërmjet nxënësve më të rritur dhe nxënësve të rinj/të vegjël.

- Të punuarit ngushtësisht me autoritetet për organizimin e veprimtarive ekstrakurrikulare dhe jashtëkurrikulare për nxënësit etj.

VII.4. Hapi IV: Si do ta kuptojmë që ia kemi dalë atje ku deshëm të arrijmë?

1. Zhvillimi i disa treguesve që na ndihmojnë në monitorimin e progresit dhe që na tregojnë se kur e kemi arritur synimin tonë.
2. Monitorimi i planit të veprimit për të siguruar sa mirë po ia dalim dhe çfarë duhet bërë, nëse gjërat nuk shkojnë ashtu si u planifikuan në fillim.
3. Nxjerrja e mësimëve për vitin e ardhshëm shkollor për gjithçka që funksionon dhe për gjithçka që nuk funksionon.

VII.5. Hapi V: Sa do të kushtojë?

1. Shumica e veprimtarive mund të mos kushtojnë asgjë, ndonjë/disë mund të kushtojnë shumë pak. Duhet përqendruar në këtë të fundit!

2. Shkolla duhet të jetë reale për atë se sa mund të bëjë në kuadër të buxhetit që ka/që mund të sigurojë.

VII.6. Hapi VI: Cili mund t'i ndihmojë shkollën dhe aktorët e përfshirë në nismën "Çdo fëmijë në shkollë"?

Mendoni se cili mund t'i ndihmojë shkollën dhe aktorët e përfshirë në parandalimin e braktisjes shkollore dhe reagimin ndaj tendencës për braktisjen e shkollës nga nxënësit: (i) për fonde, (ii) për mbështetje në natyrë, (iii) për burime njerëzore, (iv) për ekspertizë, (v) për punë në terren të rrjeteve, (vi) për ide të mira. Një listë të pashteruar po e japim në vijim:

- Organizatat e shoqërisë civile.
- Autoritetet në nivel bashkie: ZVA-ja, NjMF-ja, Komisariati i Policisë, kryetari i bashkisë, përgjegjësi i njësisë administrative, punonjësi i policisë së zonës, policia në komunitet, shkollat e tjera (përfshirë dhe kopshtet e arsimit parashkollor) dhe çdo grup tjetër i interesuar etj.
- Qendrat shëndetësore dhe mjekët e familjes.
- Organizatat ndërkombëtare dhe OJF-të.
- Sektori privat.

VIII. SISTEMI I PARALAJMËRIMIT TË HERSHËM PËR NXËNËSIT NË RREZIK TË BRAKTISJES SË SHKOLLËS

VIII.1. Treguesit e rrezikut të braktisjes së shkollës, mungesave pa arsye dhe aftësisë së kufizuar

Propozohet që sistemi SMIA të përfshijë treguesit e rrezikut të braktisjes së shkollës, me qëllim identifikimin më mirë të fëmijëve që janë më të prekur, kanë më shumë gjasa të braktisin shkollën, dhe që kanë më shumë nevojë për mbështetje. Me qenë se burimet dhe stafi janë të kufizuar (p.sh., mësuesit, psikologët e shkollave, punonjësit socialë), kjo mundëson një qasje të mbështetur në evidenca dhe siguron që ata që kanë më shumë nevojë për mbështetje, të kenë më shumë mundësi për ta marrë atë.

Lista e treguesve të rrezikut të braktisjes së shkollës bazohet në *Kuadrin e ISU-së dhe UNICEF-it për Monitorimin e Fëmijëve Jashtë Sistemit Arsimor*, i cili përfshin një listë më të plotë, mbi bazën e shqyrtimit të literaturës.⁸ Propozohet që administrata e sistemit SMIA për nxënësit të përfshijë një faqe/skedë informacioni të nxënësve me fusha të përcaktuara. Faktorët e përfshirë në këtë skedë janë faktorë rreziku kyç sipas shqyrtimit të literaturës të kryer për *Kuadrin e Monitorimit të Fëmijëve Jashtë Sistemit Arsimor* i UNICEF-it dhe ISU-së, dhe janë konstatuar të jenë, gjithashtu, çështje kyç edhe në Shqipëri dhe në rajon, bazuar në diskutimet me përfaqësues të qeverisë dhe të OJF-ve, me drejtorë të shkollave dhe me mësues. Një listë edhe më e gjatë mund të gjendet në *Kuadrin e Monitorimit*. Megjithatë, shtimi i më shumë treguesve mund të mbingarkojë mësuesit, pasi disa lloje informacionesh janë të vështira për t'u marrë.

VIII.2. Shkolla virtuale e sistemit SMIA dhe alarmet automatike

Sistemi SMIA ka një funksion “shkolle virtuale”, i cili u mundëson nxënësve që nuk ndjekin shkollën, ose që e kanë braktisur atë, të përfshihen në sistem brenda një “shkolle virtuale”. Propozohet lista e fëmijëve që rezultojnë nga marrëveshja e bashkëpunimit ndërministror. Kjo mund të jetë, për shembull, një faqe në formatin Excel, me një listë të fëmijëve të moshës së shkollës që pritet të hyjnë në shkollë në vitin e ardhshëm shkollor. OJF-të mund të luajnë një rol të rëndësishëm në verifikimin dhe plotësimin e listës me listat e tyre të fëmijëve në rrezik me të cilët ata punojnë, të cilët mund të jenë “të padukshëm” në të dhënat zyrtare (të qeverisë).

Gjithashtu, një listë mund të vijë në mënyrë të drejtpërdrejtë nga regjistri civil, pasi është parashikuar një shërbim në internet, me anë të të cilit gjendja civile mund të komunikojë drejtpërdrejt me sistemin SMIA. Çdo e dhënë e fëmijës do të ketë nevojë për përfshirjen e datëlindjes për të përcaktuar moshën, adresën dhe detajet e kontaktit dhe identitetit personal, nëse ka. Adresa mund të përdoret për të caktuar një rajon bashkie dhe zone të veçantë shkolle dhe për të shpërndarë përgjegjësinë për fëmijën.

Po ashtu, një listë e dytë mund të vijë nga sistemi i ri i informacionit të imunizimit (SII).⁹ Sigurisht, që, kur shtohen të dhëna të reja, duhet të verifikohet nëse kjo e dhënë ekziston për fëmijën, për të evituar dublimin.

Propozohet që sistemi SMIA të përfshijë në mënyrë automatike lloje të ndryshme alarmesh ose mekanizma komunikimi:

Alarmi 1: Kur fëmijët në shkollën virtuale janë në moshën e detyrimit shkollor dhe të peregjistruar brenda një date të caktuar, dërgohet një alarm në ZVA-në dhe shkollën në zonën përkatëse (nëse është e mundur) me të dhënat e nxënësve, që të merren masa.

Alarmi 2: Kur një fëmijë është i regjistruar në shkollë dhe nuk ka kartë identiteti, ose të dhënat e të cilit nuk mund gjenden në regjistrin civil, dërgohet një alarm në departamentin përkatës të MB-së me të dhënat e nxënësit, që të merren masa.

⁸UNICEF dhe ISU (2015, në pritje për t'u publikuar). *Kuadri i Monitorimit të Fëmijëve Jashtë Sistemit Arsimor: Kuadri i Monitorimit të fëmijëve dhe adoleshentëve që janë jashtë sistemit arsimor ose në rrezik për braktisjen e shkollës në Rajonin e Europës dhe Azisë Qendrore*, Gjenevë: Zyra Rajonale e UNICEF-it për Europën dhe Azinë Qendrore.

⁹http://www.who.int/immunization/programmes_systems/supply_chain/optimize/albania/en/

Alarmi 3: Kur një fëmijë është regjistruar në shkollë, por prindërit nuk kanë paraqitur dëshminë e vaksinimit brenda një date të caktuar, dërgohet një alarm në departamentin përkatës të MShMS-së, që të merren masa. Propozohet që sistemi SMIA të lidhet me sistemin e ri të informacionit të imunizimit,¹⁰ që ky informacion të mund të shkëmbehet në mënyrë automatike.

Alarmi 4: Nëse një fëmijë mungon në shkollë dhe nuk ka dhënë asnjë arsye të justifikuar/shënim, dërgohet një alarm (p.sh., përmes SMS) te prindërit dhe një alarm për stafin përkatës të shkollës (p.sh., nëpërmjet *e-mail-it*, dhe/ose një alarm kur ata të hyjnë herën tjetër në sistemin e menaxhimit të shkollës), që të marrin masa.

Alarmi 5: Nëse një fëmijë mungon për një afat të gjatë, dërgohet një alarm te subjektet përkatëse për të hetuar këtë çështje, p.sh., të ZVA-ja, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, polici etj. Do të ishte ideale, nëse alarmi i dërgohet një organi koordinues (p.sh., në Armeni ka “menaxherë të rastit” që koordinojnë reagimin), me qëllim (i) shmangien e dublimit të punës që po kryhet nga institucione të ndryshme, (ii) shmangien e mosndërmarrjes së veprimit, për shkak se një departament mendon se rasti po trajtohet ndërkohë nga një departament tjetër, dhe (iii) koordinimin e reagimit kur nevojitet veprim nga më shumë se një subjekt që punon me fëmijët në rrethana të vështira.

Marrëveshjet ose “kontratat” e performancës afatgjatë janë krijuar midis shkollave, bashkive dhe qeverisë për të reduktuar braktisjen e hershme të shkollës. Vlerësohet performanca e institucioneve arsimore në reduktimin e normës së braktisjes së shkollës krahasuar me të mëparshmen.

VIII.3. Rekomandime të tjera për sistemin SMIA

1. Të mbahen të dhëna të plota të nxënësve të paktën derisa të arrijnë moshën 25 vjeç. Kjo duhet: (i) për të llogaritur treguesin e EUROSTAT për “Të larguarit e hershëm nga shkolla” dhe, në përgjithësi, për monitorimin e pjesëmarrjes përtej moshës së arsimit të detyruar, dhe (ii) për të lehtësuar integrimin përsëri në shkollë të nxënësve që e kanë braktisur atë, pasi të dhënat e tyre të plota të arsimit duhet të jenë ende në sistem.
2. Të përfshihet e plotë popullsia në moshën e shkollës. Që sistemi SMIA të përfshijë tërë popullsinë në moshën e shkollës, duhet që të përfshihen të dhënat e fëmijëve në shkollat private, shkollat që ofrojnë edhe arsimim me kohë të pjesshme, institucionet parashkollore dhe institucione të tjera arsimore (si institucionet e arsimit special për fëmijët me aftësi të kufizuara). Regjistrimi në programe të cilat nuk janë të njohura nga shteti si të barasvlershme me arsimin formal, duhet të llogaritet veçmas, për shifrën e regjistrimit në programet e njohura si të barasvlershme me ato të arsimit formal: për shembull, arsimin joformal ose fetar, i cili nuk përfshin përmbajtje të mjaftueshme kurrikulare ose kohëzgjatje.
3. Të përmirësohet regjistrimi i mungesave. Aktualisht, mësuesit duhet të shkruajnë me anë të një kodi shkakun e mungesave. Kjo mund të jetë jopraktike për tabletat. Propozohet që të krijohet një ndërfaqe me ekran me prekje, ku të përzgjidhet prania ose mungesa e çdo fëmije, p.sh., nëpërmjet një përzgjedhjeje nga në listë për çdo nxënës. Për më tepër, për të siguruar që mësuesit ta plotësojnë këtë informacion, është e rekomandueshme që ata të tregojnë gjithashtu nëse një nxënës është i pranishëm, apo jo, dhe jo thjesht që mungon. Kjo është e rëndësishme që praktika të bëhet rutinë e punës dhe të mos harrohet, dhe për t’i bërë mësuesit më të përgjegjshëm. Më tepër shpjegime se pse kjo qasje është konsideruar si efektive për raportimin e saktë të mungesave, paraqitet më poshtë në “*Trajtimi i raportimit të pasaktë të braktisjes dhe mungesave pa arsye*”.
4. Regjistrimi i braktisjes. Kur një fëmijë ka braktisur shkollën, rekomandohet që personeli i shkollës të plotësojë formularin e braktisjes për nxënësin, i cili mund të përdoret për të monitoruar dhe për të analizuar arsyet e braktisjes. Formulari i braktisjes mund të jetë pjesë e të dhënave të nxënësit (Shënim. Një nxënës që ka braktisur shkollën, sigurisht që mund të kthehet në shkollë më pas; prandaj të dhënat e tij nuk duhet të hiqen nga sistemi).

¹⁰http://www.path.org/publications/files/TS_opt_albania_iis_fs.pdf

VIII.4. Trajtimi i raportimit të pasaktë të braktisjes dhe i mungesave pa arsye

Një nga çështjet kryesore, bazuar në diskutimet me institucionet arsimore parauniversitare (në nivel qendror e vendor) dhe me përfaqësuesit e OJF-ve, është raportimi i pasaktë i braktisjes. Nxitja për raportim të saktë të mungesave pa arsye të nxënësve dhe të braktisjes duhet të jetë më e lartë se nxitja për të mos e raportuar këtë informacion. Prandaj, shkolla dhe organet e tjera që raportojnë këto shifra, duhet të ndëshkohen për raportim të pasaktë dhe/ose të shpërblehen për raportim të saktë. Qasjet e mëposhtme rekomandohen si stimul për raportimin e FJSA-ve:

Të mos ndëshkohet raportimi i FJSA-ve dhe i mungesave pa arsye. Është tejet kritike që shkollat të ndëshkohen në mënyrë të padrejtë për raportimin e FJSA-ve dhe mungesave pa arsye, dhe që shkollat nuk kanë frikë se mund të ndëshkohen në mënyrë të padrejtë. Në të kundërt, shkollat duhet ndihën të sigurt se do të mbështeten, në qoftë se kanë një numër të lartë të braktisjes së shkollës (siç diskutohet më poshtë), dhe sigurisht që shkollat nuk duhet të marrin gjithë fajin në rast normash të larta të braktisjes së shkollës. Ka shumë faktorë që ndikojnë në braktisjen, të cilët nuk janë të lidhur me shkollën. Problemi mund të qëndrojë se shkollat nuk marrin mbështetjen e nevojshme. Kjo është e pashmangshme, megjithatë, që shkolla të ndëshkohet, nëse zbatohet financimi “për nxënës”, pra raportimi i braktisjes mund të ketë pasoja të drejtpërdrejta, për shembull, mbi numrin e mësuesve në shkollë. Pikat e mëposhtme japin qasje të ndryshme për trajtimin e kësaj pengese të mundshme në raportimin e shifrave të sakta.

Të ndëshkohet mosraportimi i FJSA-ve dhe i mungesave pa arsye. Një zgjidhje mund të jetë gjorbitja e atyre shkollave që nuk raportojnë saktë FJSA-të ose mungesat pa arsye. Përveç kësaj, ose si një qasje plotësuese, shkollat mund të ndëshkohen nëpërmjet një sistemi renditjeje publike. Mosraportimi i saktë i FJSA-ve dhe/ose i mungesave pa arsye do të bëjë që shkolla të marrë renditjen më të ulët të besueshmërisë, dhe ky informacion mund të publikohet në internet dhe të jetë i hapur për publikun. Shkollat që renditen në nivelin më të ulët në aspektin e besueshmërisë, mund të jenë objekt inspektimesh më të shpeshta. Një shembull i sistemit të renditjes është Agjencia e Arsimit e Teksasit, e cila cakton vlerësime vjetore besueshmërie, si për shkollat dhe për rrethet, në shtetin e Teksasit në Shtetet e Bashkuara (Agjencia e Arsimit, Teksas, 2000).¹¹ Për të siguruar që shkollat të raportojnë me saktësi braktisjen, si pjesë e renditjes së besueshmërisë, është përfshirë dhe “Dhëna e Masës së Cilësisë”. Shkollat që nuk arrijnë të raportojnë me saktësi të dhënat e braktisjes së shkollës, marrin normën më të ulët. Kjo vendos presion, mbi shkollat dhe mbi rrethet, dhe ky presion mund të çojë në përmirësimin e besueshmërisë. Nëse shkolla raporton në mënyrë të besueshme mungesat pa arsye, ky informacion mund të përdoret për të përcaktuar dhe për të llogaritur braktisjen pa u mbështetur në raportet e braktisjes së shkollës. Besueshmëria e shkollës mund të përfshihet si një nga treguesit që do të monitorohen në nivel vendor dhe kombëtar.

Të nxitet raportimi i FJSA-ve, i mungesave pa arsye dhe i fëmijëve që rrezikojnë të braktisin shkollën. Siç tregohet më sipër, braktisja e shkollës mund të vijë si pasojë e mosmarrjes së mbështetjes për të cilën shkolla ka nevojë. Është shumë e rëndësishme që shkollat të mos ndiejnë se ato vetëm raportojnë shifra dhe, në këmbim të kësaj, kurrë nuk marrin asgjë. Informacioni duhet të rrjedhë në të dy krahët. Së dyti, stafet e shkollave duhet të mendojnë se sa më i detajuar dhe i saktë të jetë informacioni që ato ofrojnë, aq më e mirë dhe më e përshtatur do të jetë mbështetja që do të marrin.

Të dhënat tregojnë se shkollat e pafavorizuara nga ana socio-ekonomike, të cilat priren të kenë norma më të larta të braktisjes së shkollës në krahasim me shkollat me avantazh socio-ekonomik, aktualisht nuk marrin mbështetjen që u nevojitet. Qasja e parë që trajton problemin e braktisjes së lartë në shkolla të caktuara, nuk është që të ndëshkohet shkolla, por të hetohet se cilat janë arsyet e braktisjes së shkollës dhe si mund të mbështetet më mirë shkolla. Stafi i shkollës duhet të ndihet i sigurt se do të trajtohet në mënyrë të drejtë dhe se do të marrë mbështetjen shtesë, nëse është e nevojshme, në rast se ai raporton FJSA-të, mungesat pa arsye dhe fëmijët që rrezikojnë të braktisin shkollën.

Të përfshihet një tregues i mungesave pa arsye që nuk është i lidhur me ndonjë pasojë. Nëse raportimi i braktisjes ose i mosfrekuentimit në masë, apo i mungesave pa arsye kanë ndikim të menjëhershëm mbi stafin, atëherë kjo do të jetë një shkurajim për të raportuar. Për shembull, kjo

¹¹<http://www.tea.state.tx.us/perfreport/>

mund të çojë në provime shtesë që do të organizohen për nxënësit në fund të vitit shkollor, takime me prindërit dhe marrja e masave për përsëritje të detyrueshme të klasës nga nxënësit mbetës. Siç u theksua më sipër, aty ku është i zbatueshëm financimi “për nxënës”, raportimi i braktisjes mund të ketë pasoja financiare. Për arsyet e mësipërme, mund të jetë e dobishme që të jenë një ose më shumë tregues të mungesave pa arsye, që do të përdoren vetëm për qëllime monitorimi, duke e bërë shumë të qartë se nuk do të ketë pasoja apo ndëshkime që lidhen me treguesit.

Regjistrimi i informacionit në një mënyrë të tillë që FJSA-të janë të vështirë për t'u fshehur:

Rekomandohet që shkollat të regjistrojnë jo thjesht “mungesat”, por edhe “pjesëmarrjen”. Regjistrimi i të pranishmëve duhet të bëhet një proces i përhershëm, një rutinë e përditshme; kështu ky aktivitet i rëndësishëm do të bëhet në vazhdimësi. Në situatë ideale, regjistri i pjesëmarrjes funksionon si një listë e plotë e cila gjithmonë duhet të plotësohet, dhe jo vetëm kur një nxënës mungon.¹² Në qoftë se regjistrohen vetëm mungesat, atëherë kjo nuk do të bëhet rutinë, dhe ka shumë gjasa që të harrohet ose të hiqet. Regjistrimi i pjesëmarrjes i bën mësuesit më të përgjegjshëm dhe nuk i lejon të mbajnë shënime të pasakta. Një nxënës që mungon, do të duhej të regjistrohet qëllimisht ose gabimisht si i pranishëm, në vend që të jetë një lëshim (nga harresa për të regjistruar mungesat). Në rrugë elektronike ndoshta, kurse në regjistrë shënohen vetëm mungesat.

Përveç pjesëmarrjes, mësuesit regjistrojnë zakonisht edhe informacione të tjera për çdo nxënës, të tilla si notat në detyra dhe teste, ditar personal etj. Nëse ky informacion do të jetë i regjistruar në sistemin SMIA, në vend të (ose përveç) regjistrimit në letër, kjo gjë do të mundësojë identifikimin automatik të fëmijëve, kur ky informacion mungon, kryerjen e një hetimi për të parë nëse ky fëmijë po e ndjek ende shkollën. Është e vështirë të falsifikohen të dhënat e pjesëmarrjes, ditari i një nxënësi, notat e detyrave dhe testeve, e kështu me radhë. Prandaj, kontrolli i këtij informacioni mund të jetë një pengesë e rëndësishme për falsifikimin e frekuentimit.

Monitorim automatik dhe kontroll i tërthortë i informacionit për të identifikuar raportimin e pasaktë të FJSA-ve:

Kontrolle automatike mund të bëhen për të zbuluar anomali, që do të thotë të zbulohen fëmijë që nuk kanë qenë të pranishëm dhe nuk janë regjistruar si të tillë, ose gabime apo mungesa në hedhjen e të dhënave, përkatësisht:

- *Kontroll automatik i informacionit për të njëjtin nxënës siç është shënuar nga shkolla të ndryshme.*
- *Kontroll i tërthortë automatik i sistemit SMIA me burime të tjera të informacionit në lidhje me fëmijën, për shembull, në qoftë se fëmija është i regjistruar se jeton në rajonin X, ai nuk mund të regjistrohet në një shkollë në rajonin Y.*
- *Inspektim i rregullt në shkollë (pa e lajmëruar më parë shkollën), gjatë të cilit informacioni rikontrollohet për të identifikuar raportimin e pasaktë të mungesave pa arsye:*
 1. Inspektorët e DPAP-së/DRAP-ve / specialistët e ZVA-ve duhet të verifikojnë informacionin ndërmjet dy formularëve të shkollës për regjistrimin e të njëjtit informacion.
 2. Inspektorët DPAP-së/DRAP-ve / specialistët e ZVA-ve duhet të verifikojnë të dhënat aktuale të frekuentimit me pjesëmarrjen aktuale në klasë.

¹² Një listë kontrolli e metodës “Poka-Yoke” (ose e gjetjes së gabimeve) (Shingo, 1986).

IX. MONITORIMI, RAPORTIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi i zbatimit të M3M dhe U3M është një aspekt i rëndësishëm për të tri ministritë e linjës dhe institucionet e tyre të vartësisë në nivel qendror dhe vendor. Së pari, duhet siguruar që të gjitha institucionet që kanë role e përgjegjësi, t'i hartojnë dhe t'i zbatojnë dokumentet përkatëse (lista, tabela sipas shtojcave, plane veprimi, raportime etj.).

ZVA-ja, si institucion përgjegjës në nivel bashkie, monitoron në vazhdimësi punën dhe rezultatet e arritura nga shkollat. Në kuadër të këtij procesi, ZVA-ja kërkon rregullisht nga shkollat informacionet dhe raportet për veprimtaritë, gjetjet dhe sfidat e tyre gjatë realizimit të M3M dhe U3M. Të gjitha të dhënat duhet të jenë në formë të shkruar (si p.sh.: procesverbali i takimeve, të dhënat statistikore mbi rastet e ndjekura, listat e fëmijëve braktisës të shkollës, raportet përmbledhëse në mbarim të periudhave të caktuara sipas M3M-së dhe U3M-së, si dhe SMIA-s etj.).

ZVA-ja, së paku një herë në vit, bën vlerësimin e punës së saj dhe të shkollave në juridiksion të saj. Rezultatet e vlerësimeve ndihmojnë ZVA-në dhe shkollat për rishikimin dhe përmirësimin e planeve të tyre të veprimit, në përshtatje me situatat e reja që krijohen kohë pas kohe.

Bazuar në monitorimet, raportimet, analizat e vlerësimit, ZVA-ja dhe shkollat hartojnë planet e veprimit dhe zhvillojnë veprimtari konkrete për trajtimin me efikasitet të problematikës në fjalë. Të gjitha të dhënat e mbledhura, ZVA-ja dhe shkollat i analizojnë dhe i sintetizojnë për të identifikuar çështjet, pengesat dhe përparësitë për realizimin e vijueshmërisë së rregullt të shkollës nga të gjithë fëmijët e moshës së detyrimit shkollor.

ZVA-të i raportojnë MASR-së dhe Komisionit Ndërmintor të Ndjekjes së Arsimit nga Nxënësit për parandalimin e braktisjes shkollore dhe për reagimin ndaj mosregjistrimit të nxënësve në arsimin bazë. Raportimet bëhen në periudha të caktuara apo edhe në bazë të kërkesës mbi veprimtaritë, gjetjet dhe sfidat e tyre gjatë realizimit të nismës "Çdo fëmijë në shkollë". Këto të dhëna duhet të jenë në formë të shkruar, por dhe në format elektronik, për të gjitha rastet e kërkuara, siç përcaktohet në M3M dhe në U3M. Të gjitha të dhëna i shërbejnë Komisionit Ndërmintor të Ndjekjes së Arsimit nga Nxënësit për orientimin e politikave kombëtare për gjithëpërfshirjen në arsim.

X. SHTOJCAT

Shtojca 1: Instrumente për intervista

Instrumenti 1: Intervista me drejtorin e shkollës

1.1. Braktisja e shkollës

(Pyeten vetëm ato shkolla që kanë nxënës braktisës)

1. Sa nxënës e kanë braktisur shkollën tuaj gjatë vitit të kaluar mësimor?
2. Sa për qind janë këta nxënës në shkollën tuaj?
3. A keni nxënës që janë kthyer në shkollë pasi e kanë braktisur atë?
Pse ka ndodhur kjo?
4. Cilat janë shkaqet kryesore që nxënësit braktisin shkollën tuaj?
[Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mëposhtme të drejtorit dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai.]
 - a) Nxënësit nuk jetojnë me prindërit biologjikë.
 - b) Nxënësit i përkasin një pakice etnike.
 - c) Nxënësit kanë vështirësi të shkojnë në shkollë për shkak të largësisë së madhe nga vendbanimi.
 - d) Nxënësit kanë vështirësi në mësim.
 - e) Nxënësit kanë probleme të sjelljes.
 - f) Familjet e nxënësve kanë vështirësi ekonomike, prandaj djali u duhet si krahë pune.
 - g) Familjet e nxënësve kanë shumë fëmijë, prandaj u duhet vajza për t'u kujdesur për fëmijët e tjerë.
 - h) Familja dhe farefisi kanë paragjytime për vajzat.
 - i) Të tjera shtojë
5. Cilët janë nxënësit më në rrezik për të braktisur shkollën tuaj?
{Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mëposhtme të drejtorit dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai.}
 - a) Nxënësit nuk jetojnë me prindërit biologjikë.
 - b) Nxënësit i përkasin një pakice etnike.
 - c) Nxënësit kanë vështirësi të shkojnë në shkollë për shkak të largësisë së madhe nga vendbanimi.
 - d) Nxënësit kanë vështirësi në të nxënë.
 - e) Nxënësit kanë probleme të sjelljes.
 - f) Familjet e nxënësve kanë vështirësi ekonomike, prandaj djali u duhet si krahë pune.
 - g) Familjet e nxënësve kanë shumë fëmijë, prandaj u duhet vajza për t'u kujdesur për fëmijët e tjerë.
 - h) Familja dhe farefisi kanë paragjytime për vajzat.
 - i) Shtojë të tjera...
6. Cila është përvoja e shkollën suaj për të parandaluar braktisjen e nxënësve?
7. Ju lutem, mund të na thoni ndonjë episod të punës suaj për pakësimin e braktisjes së shkollës që ju ka bërë përshtypje?

1.2. Mungesat e paarsyeshme

1. Sa është përqindja e mungesave vjetore e të gjithë nxënësve kundrejt të gjitha orëve mësimore?
2. Cila është përvoja e shkollës suaj kur një nxënës mungon gjatë gjithë ditës?
3. Cila është përvoja e shkollës suaj kur një nxënës largohet në disa nga orët e mësimi?
4. Cila është përvoja e shkollës suaj për mungesat e paarsyeshme të nxënësve?
[Shihni a e njeh dhe a e zbaton i intervistuari nenin përkatës të Rregullores për institucionet arsimore parauniversitare].

Nxënësi i klasave IV-IX që, gjatë një periudhe, mungon në më shumë se 35% deri në 50% të orëve mësimore të një lënde, i nënshtrohet provimit për orët e munguara, në datën e caktuar nga mësuesi në bashkëpunim me prindin e nxënësit dhe të miratuar nga drejtori i shkollës. Notat e çdo provimi vendosen në shtylla të veçanta të regjistrimit.

Përjashtimi është për nxënësit të cilëve shkolla u krijon kushte për mësimin në shtëpi nga mësues të caktuar nga drejtori i shkollës.

Nxënësi i klasave IV-IX, që mungon më shumë se 50% të orëve mësimore të një lënde gjatë një periudhe, është pakalues në atë lëndë për atë periudhë.

Nxënësi i shkollës së arsimit të mesëm të lartë, që mungon 20-30% të orëve mësimore të një lënde gjatë një periudhe, i nënshtrohet provimit për orët e munguara, në datën e caktuar nga mësuesi në bashkëpunim me prindin e nxënësit dhe të miratuar nga drejtori i shkollës. Notat e çdo provimi vendosen në shtylla të veçanta të regjistrimit.

Nxënësi i shkollës së arsimit të mesëm të lartë, që mungon më shumë se 30% të orëve mësimore të një lënde gjatë një periudhe, është pakalues në atë lëndë për atë periudhë.

Nxënësit të shkollës së arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë, që, për arsye shëndetësore (shtrim në spital apo regjim shtrati me raport mjeko-ligjor), mungon më shumë se 30% të orëve mësimore gjatë një periudhe, i ofrohet nga shkolla mësim në kushtet spitalore apo të shtëpisë. Në këto raste, nxënësi merret në provim në fund të periudhës. Notat e çdo provimi vendosen në shtylla të veçanta të regjistrimit.

5. Cila është përvoja e shkollës suaj për të parandaluar mungesat e paarsyeshme?
nenin përkatës të Rregullores për institucionet arsimore parauniversitare].

Kur nxënësi i klasave I-III, mungon për një periudhë të vitit mësimor, mësuesi: a) në bashkëpunim me prindërit, hartojnë planin e punës së prindërve me fëmijën gjatë periudhës që fëmija mungon në shkollë dhe gjatë pushimeve verore; b) zbaton një program individual për nxënësin gjatë kohës që kthehet në shkollë.

Në fillim të vitit pasues, mësuesi vlerëson rezultatet e nxënësit bazuar në kompetencat e klasës paraardhëse, dhe, sipas rastit, vazhdon me program individual.

6. Ju lutem, mund të na thoni ndonjë episod të punës suaj për pakësimin e mungesave të paarsyeshme në shkollë që ju ka bërë përshtypje?

1.3. Regjistrimi i nxënësve

1. Cila është përvoja e shkollës suaj kur një nxënës nuk regjistrohet në klasën pasuese? (P.sh., ka mbaruar klasën e 7-të dhe duhet të regjistrohet në klasën e 8-të)
2. Cilat janë shkaqet kryesore që këta nxënës nuk regjistrohen?
[Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mëposhtme të drejtorit dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai.]
 - a) Nxënësi e braktisi shkollën.
 - b) Nxënësi transferohet në një shkollë tjetër.
 - c) Familja e nxënësit transferohet në një vendbanim tjetër.
 - d) Shto të tjera...
3. Ju lutem, mund të na thoni ndonjë episod të punës suaj për regjistrimin e nxënësve në klasën pasuese?

1.4. Nxënësit me aftësi të kufizuara

Intervista zhvillohet vetëm me ato shkolla që kanë nxënës me AK.

1. Cila është përvoja juaj me Komisionin për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara (AK) në shkollë? Përse ka qenë e dobishme kjo përvojë?
2. A i jeni drejtuar ndonjëherë Komisionit Multidisiplinar për Fëmijët me Aftësi të Kufizuara (AK) në ZVA? Nëse "PO", pse ka qenë e nevojshme për ju?

IAVPAP ngre komisionin multidisiplinar të përbërë nga një mjek peditër (kur është e mundur, mjek peditër zhvillimi), një psikolog, një punonjës social, një mësues (kur është e mundur, mësues i kualifikuar për arsimin e specializuar) dhe drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social.

IAVPAP, në bazë të numrit të institucioneve arsimore që mbulon dhe në bazë të numrit të nxënësve me AK, mund të ngrejë më shumë se një komision për mbulimin në kohë të nevojave për vlerësim.

Kryetar i komisionit është drejtuesi i njësisë së shërbimit psiko-social.

Komisioni i institucionit arsimor të zakonshëm, bazuar në vlerësimin e komisionit të institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar: a) udhëzon mësuesit për hartimin e PEI-ve dhe i miraton ato; b) ndihmon mësuesit gjatë zbatimit të PEI-ve; c) ndjek ecurinë e fëmijëve me AK; c) paraqet në komisionin e institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar raportin e ecurisë së nxënësit me AK, sipas formatit të vendosur nga komisioni i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

3. Si mësojnë të ju fëmijët me AK? [Përgjigjja: Fëmijët me AK mësojnë me plan mësimor dhe programe lëndore: a) të zakonshme; b) të përshtatura; c) individuale.]
4. Cilat janë sukseset e shkollës suaj me nxënësit me AK?
5. Cilat janë vështirësitë e shkollës suaj me nxënësit me AK?
6. Ju lutem, mund të na thoni ndonjë episod të punës suaj me fëmijët me AK që ju ka bërë përshtypje?
7. Si mendoni ju se mund të përmirësohet puna me fëmijët me AK?

1.5. Psikologu/punonjësi social

1. A është i rëndësishëm shërbimi i psikologut/punonjësit social në shkollën tuaj? Ku është më shumë i dobishëm ky shërbim? Po më pak?
2. Si bashkëpunoni konkretisht me psikologun/punonjësin social?
3. Ju lutem, mund të na thoni ndonjë episod të bashkëpunimit tuaj me psikologun/punonjësin social që ju ka bërë më shumë përshtypje?
4. Si mendoni ju se mund të përmirësohet bashkëpunimi me psikologun/punonjësin social të shkollës suaj?

1.6. Regjistrimi i fëmijëve në klasën e parë

[Zbatimi i Urdhrit të Përbashkët të tri ministrave (U3M)]

1. A e keni Rregulloren e nënshkruar nga 3 ministrat (U3M) për regjistrimin e nxënësve të klasës së parë?
2. A është e qartë ajo për ju? Cilat janë paqartësitë që keni?
3. Cila është përvoja e shkollës suaj në zbatimin e kësaj Rregulloreje?
Cilat janë vështirësitë që keni hasur?
4. Cilat janë përmirësimet që propozoni?

[- Drejtorët e shkollave, brenda 3 ditëve pune pas datës së fillimit të çdo viti shkollor, t'u dërgojnë ZVA-ve, në format elektronik dhe me shkresë zyrtare, listën emërore të fëmijëve që janë të regjistruar në klasën e parë, duke pasur parasysh përbërësit: Emri i fëmijës, mbiemri, emri i babait, emri i nënës, numri personal, gjinia, datëlindja, vendlindja dhe vendbanimi.

- Mësuesit e shkollave publike përkatëse të merren me regjistrimin e fëmijëve të zonës së tyre që janë identifikuar nga punonjësi i policisë së zonës dhe personi përgjegjës i nënndarjes administrative.

- Drejtori i shkollës publike të njoftojë ZVA-në përkatëse për efektivitetin e përpjekjeve për regjistrimin e këtyre fëmijëve.]

Instrumenti 2: Intervista me mësuesin kujdestar

2.1. Braktisja e shkollës

Intervista zhvillohet me një mësuese filloreje dhe një tjetër të arsimit të mesëm të ulët.

Klasat përkatëse i cakton drejtori i shkollës.

1. Sa nxënës e kanë braktisur klasën tuaj gjatë vitit të kaluar mësimor?
2. A keni nxënës që janë kthyer në shkollë pasi e kanë braktisur atë?
Pse ka ndodhur kjo?
3. Cilat janë shkaqet kryesore që nxënësit tuaj e kanë braktisur shkollën?
[Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mëposhtme të mësuesit dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai.]
 - a) Nxënësit nuk jetojnë me prindërit biologjikë.
 - b) Nxënësit i përkasin një pakice etnike.

- c) Nxënësit kanë vështirësi të shkojnë në shkollë për shkak të largësisë së madhe nga vendbanimi.
 - d) Nxënësit kanë vështirësi në të nxënë.
 - e) Nxënësit kanë probleme të sjelljes.
 - f) Familjet e nxënësve kanë vështirësi ekonomike, prandaj djali u duhet si krahë pune.
 - g) Familjet e nxënësve kanë shumë fëmijë, prandaj u duhet vajza për t'u kujdesur për fëmijët e tjerë.
 - h) Familja dhe farefisi kanë paragjytime për vajzat.
 - i) Shto të tjera...
4. Cilët janë nxënësit tuaj më në rrezik për të braktisur mësimet?
[Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mëposhtme të mësuesit dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai.]
- a) Nxënësit nuk jetojnë me prindërit biologjikë.
 - b) Nxënësit i përkasin një pakice etnike.
 - c) Nxënësit kanë vështirësi të shkojnë në shkollë për shkak të largësisë së madhe nga vendbanimi.
 - d) Nxënësit kanë vështirësi në të nxënë.
 - e) Nxënësit kanë probleme të sjelljes.
 - f) Familjet e nxënësve kanë vështirësi ekonomike, prandaj djali u duhet si krahë pune.
 - g) Familjet e nxënësve kanë shumë fëmijë, prandaj u duhet vajza për t'u kujdesur për fëmijët e tjerë.
 - h) Familja dhe farefisi kanë paragjytime për vajzat.
 - i) Shto të tjera...
5. Çfarë bëni ju në klasën tuaj që të parandaloni braktisjen e nxënësve?
6. Ju lutem, mund të na thoni ndonjë episod të punës suaj për pakësimin e braktisjes së shkollës që ju ka bërë përshtypje?

2.2. Mungesat e paarsyeshme

Intervista zhvillohet me një mësuese filloreje dhe një tjetër të arsimit të mesëm të ulët.

Klasat përkatëse i cakton drejtori i shkollës.

Si veproni ju kur një nxënës i klasës suaj mungon gjatë gjithë ditës?

1. Si veproni ju kur një nxënës largohet në disa nga orët e mësimet?
2. Si veproni ju për mungesat e paarsyeshme të nxënësve?
[Shihni a e njeh dhe a e zbaton i intervistuari nenin përkatës të Rregullores për institucionet arsimore parauniversitare.]
3. Si i parandaloni ju mungesat e paarsyeshme në klasën tuaj?
4. Ju lutem, mund të na thoni ndonjë episod të punës tuaj për pakësimin e mungesave të paarsyeshme që ju ka bërë përshtypje?

2.3. Regjistrimi i nxënësve

Intervista zhvillohet me një mësuese filloreje dhe një tjetër të arsimit të mesëm të ulët.

Klasat përkatëse i cakton drejtori i shkollës.

1. Si veproni ju kur një nxënës i klasës suaj nuk regjistrohet në klasën pasuese? (P.sh., ka mbaruar klasën e 7-të dhe duhet të regjistrohet në klasën e 8-të)
2. Cilat janë shkaqet kryesore që këta nxënës nuk regjistrohen?
[Rrumbullakosni një ose disa nga përgjigjet e mëposhtme të mësuesit dhe shkruani përgjigje të tjera që mund të shtojë ai.]
- a) Nxënësi e braktisi shkollën.
- b) Nxënësi transferohet në një shkollë tjetër.
- c) Familja e nxënësit transferohet në një vendbanim tjetër.
- d) Shto të tjera...
3. Ju lutem, mund të na thoni ndonjë episod të punës suaj, që ju ka bërë përshtypje, kur një nxënës i juaj nuk regjistrohet në klasën pasuese?

2.4. Nxënësit me AK

Intervista zhvillohet me një mësuese filloreje dhe një tjetër të arsimit të mesëm të ulët.

Klasat përkatëse i cakton drejtori i shkollës.

1. Sa nxënës me aftësi të kufizuara keni në klasën tuaj?
2. Çfarë lloj aftësish të kufizuara kanë nxënësit në klasën tuaj?
(Rrumbullakosni përgjigjen e mësuesit.)

Fëmijët me aftësi të kufizuara për nga lloji i aftësisë së kufizuar
1. Të parit
1a. Nxënësi nuk ka vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
1b. Nxënësi ka disa vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
1c. Nxënësi ka shumë vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
2. Të dëgjuarit
2a. Nxënësi nuk ka vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
2b. Nxënësi ka disa vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
2c. Nxënësi ka shumë vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
3. Aftësi motore të zhvendosjes së trupit
3a. (p.sh., ecja ose ngjitja e shkallëve): Nxënësi nuk ka vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
3b. (p.sh., ecja ose ngjitja e shkallëve): Nxënësi ka disa vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
3c. (p.sh., ecja ose ngjitja e shkallëve): Nxënësi ka shumë vështirësi të marrë pjesë dhe të mësojë në klasë për shkak të paaftësisë.
